2025
RAPORT

MBI GJENDJEN ME FINANCIMIN KAPITAL TË SIGURIMIT PENSIONAL

Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional

MAPAS

MAPAS

Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital
të sigurimit pensional

Slavko Janevski nr. 100, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut
Tel: (+389 2) 3224 229
www.mapas.mk

Qershor 2026

PËRMBAJTJA

Shkurtesat 4

Fjalë hyrëse 5

MAPAS, misioni dhe vizioni 7

1. Pasqyrë e shkurtër e gjendjeve dhe trendeve botërore në fushën pensionale me theks në sigurimin pensional me financim kapital 9

2. Struktura e sigurimit pensional me financim kapital në Republikën e Maqedonisë së Veriut 17

2.1. Përshkrimi i sistemit pensional 18

2.2. Roli i sigurimit pensional me financim kapital në sistemin pensional 20

2.3. Institucionet në sigurimin pensional me financim kapital 22

3. Ndryshime dhe plotësime të akteve ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë sigurimin pensional me financim kapital 27

4. Të dhëna për veprimtarinë financiare të shoqërive pensionale 30

4.1. Të ardhurat dhe shpenzimet e shoqërive pensionale për vitin 2025 32

4.2. Rezultati financiar i shoqërive pensionale 36

4.3. Kapitali, kapitali themelor dhe mjetet vetanake të shoqërive pensionale 37

4.4. Treguesit 39

5. Informacione për fondet pensionale të detyrueshme 41

5.1. Anëtarësimi në fondet pensionale të detyrueshme 44

5.2. Të dhëna për anëtarësimin në fondet pensionale të detyrueshme 45

5.3. Kalimi i anëtarit nga një fond pensional i detyrueshëm në një fond tjetër pensional të detyrueshëm 51

5.4. Kontributet në fondet pensionale të detyrueshme 54

5.4.1. Kompensimi për transferimin jo në kohë të kontributeve 57

5.4.2. Mjete të kthyera në Fondin e SPIMV-së 58

5.5. Investimi dhe struktura e portofolit të fondeve pensionale të detyrueshme 59

5.6. Mjetet neto, njësia kontabël dhe norma e kthimit të fondeve pensionale të detyrueshme 69

5.7. Kompensimet te fondet pensionale të detyrueshme 82

5.8. Pagesa e pensioneve nga sigurimi pensional i detyrueshëm me financim kapital 87

6. Informacione për fondet pensionale vullnetare 90

6.1. Qëllimi i sigurimit pensional vullnetar me financim kapital 92

6.2. Anëtarësimi në fondet pensionale vullnetare 93

6.3. Kalimi i anëtarit nga një llogari në një llogari tjetër në të njëjtin ose në një fond tjetër pensional vullnetar 99

6.4. Kontributet në fondet pensionale vullnetare 101

6.5. Investimi dhe struktura e portofolit të fondeve pensionale vullnetare 103

6.6. Mjetet neto, njësia kontabël dhe norma e kthimit të fondeve pensionale vullnetare 112

6.7. Kompensimet te fondet pensionale vullnetare 124

6.8. Pagesa e kompensimeve pensionale nga sigurimi pensional vullnetar me financim kapital 128

7. Marketingu dhe agjentët e shoqërive pensionale 130

SHKURTESA

PBV • Prodhimi bruto vendor

Shtylla e dytë • Sigurimi pensional i detyruar me financim kapital

VFP • Shoqëria për menaxhim me fondet vullnetare pensionale VFP SHOQËRIA PENSIONALE SHA Shkup

VFPv • Fondi i hapur vullnetar pensional VFP– Shkup

FVP • Fondet vullnetare pensionale

ESHS • Enti Shtetëror i statistikës

BE • Bashkimi Evropian

FDP • Fonde të detyrueshme pensionale

IOPS • Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve Pensionalë
(International Organisation of Pension Supervisors)

KB e parë • KB Shoqëria e parë për administrim me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare SHA Shkup

KBPv • KB Shoqëria e fondit pensional të hapur vullnetar - Shkup

KBPd • KB Shoqëria e fondit pensional të hapur të detyrueshëm - Shkup

MAPAS • Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional

BPRMV • Banka Populllore e Republikës së Maqedonisë së Veriut

OECD • Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
(Organization for economic coopëration and developement)

Shtylla e parë • Sigurim mbi bazën e solidaritetit të gjeneratave

RMV • Republika e Maqedonisë së Veriut

SAVA • Shoqëria për administrim të fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare Sava Shoqëri Pensionale SH.A Shkup

SAVAv • Fondi pensional vullnetar i hapur Sava Pension Plus

SAVAd • Fondi pensional i detyrueshëm i hapur Fondi Pensional Sava

Shtylla e tretë • Sigurim pensional vullnetar me financim kapital

TRIGLAV • Shoqëria për administrim me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare Shoqëria PENSIONALE TRIGLAV SH.A SHKUP

TRIGLAVv • Fondi i Hapur Pensional Vullnetar Trigllav – Shkup

TRIGLAVd • Fondi i Hapur i Detyrueshëm Pensional - Shkup

DAP • Drejtoria e të Ardhurave Publike

Fondi SPIMV • Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor i Republikës së Maqedonisë së Veriut

FJALË HYRËSE

Me përfundimin e vitit 2025 përmbyllen dy dekada të funksionimit të sigurimit pensional me financim kapital në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Rezultatet dhe gjendjet kryesore në sistem janë paraqitur në Raportin për gjendjet në sigurimin pensional me financim kapital në vitin 2025 të Agjencisë për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional – MAPAS. Raporti përmban përshkrimin e karakteristikave të sigurimit pensional me financim kapital, të dhëna për sigurimin pensional me financim kapital, vlerësim të zbatimit të rregulloreve në fushën e sigurimit pensional me financim kapital dhe të dhëna të tjera me rëndësi për këtë sigurim deri në fund të vitit 2025.



Gjatë vitit 2025, mjetet e përgjithshme të fondeve pensionale të detyrueshme u rritën për 15,65% dhe arritën në 188,34 miliardë denarë. Njëkohësisht, mjetet e përgjithshme të fondeve pensionale vullnetare realizuan një rritje të ngjashme prej 15,84% dhe arritën në 5,06 miliardë denarë. Si rezultat i kësaj, pjesëmarrja e mjeteve të përgjithshme të fondeve pensionale të shtyllës së dytë dhe të tretë në BPV u rrit dhe në vitin 2025 arriti në 18,53%, prej të cilave 18,04% i referohen fondeve pensionale të detyrueshme, ndërsa 0,48% fondeve pensionale vullnetare.

Në vitin 2025 vazhdoi edhe rritja e përfshirjes së popullsisë në shtyllën e dytë, me pothuajse të njëjtën dinamikë si në vitin paraprak. Numri i anëtarëve u rrit për rreth 3% në krahasim me vitin 2024, me ç'rast përfshirja arriti në 79% të popullsisë së përgjithshme aktive. Edhe në shtyllën e tretë rritja e përfshirjes së popullsisë vazhdoi me të njëjtën dinamikë si në vitin e kaluar dhe u rrit për rreth 7% krahasuar me vitin paraprak. Megjithatë, pjesëmarrja mbetet relativisht e ulët, përkatësisht rreth 4,5% e popullsisë aktive në shtet ka llogari individuale vullnetare ose llogari profesionale në fond pensional vullnetar.

Gjatë vitit 2025, në fondet pensionale të detyrueshme u transferuan kontribute në vlerë prej rreth 17,48 miliardë denarësh, që paraqet rreth 1,67% të BPV-së. Në fondet pensionale vullnetare u paguan rreth 625,06 milionë denarë, përkatësisht rreth 0,06% të BPV-së.

Struktura e investimeve të fondeve pensionale të detyrueshme më 31.12.2025 nuk tregon ndryshime të konsiderueshme në krahasim me gjendjen në fund të vitit 2024. Portofoli investues i fondeve pensionale të detyrueshme vazhdon të jetë i orientuar në mënyrë dominante drejt letrave shtetërore me vlerë vendore, të cilat marrin pjesë me 63,74% në mjetet e përgjithshme. Një pjesë më e vogël e mjeteve është investuar në aksione vendore (1,45%), depozita në banka vendore (1,08%) dhe pjesëmarrje në fonde investuese vendore (0,51%). Njëkohësisht, i konsiderueshëm është edhe pjesëmarrja e investimeve jashtë vendit, e cila në krahasim me vitin paraprak është rritur për një

pikë përqindjeje dhe arrin në 30,98%. Pjesa më e madhe e këtyre investimeve i referohet fondeve investuese të huaja (25,46%), ndërsa pjesëmarrje më të vogël kanë investimet në aksione të huaja (3,36%), obligacione shtetërore të huaja (2,02%) dhe letra shtetërore afatshkurtra të huaja (0,14%).

E ngjashme është edhe struktura e investimeve te fondet pensionale vullnetare. Obligacionet shtetërore vendore kanë pjesëmarrjen më të madhe prej 58,84%, që paraqet rritje prej tre pikësh përqindjeje krahasuar me vitin paraprak. Një pjesë më e vogël e mjeteve është investuar në aksione vendore (4,04%), depozita në banka vendore (3,21%) dhe fonde investuese vendore (1,36%), me ç'rast te depozitat dhe aksionet vendore vërehet ulje në krahasim me vitin 2024. Investimet jashtë vendit mbeten pothuajse të pandryshuara dhe arrijnë në 31,44%, me ç'rast pjesëmarrjen më të madhe e kanë investimet në fonde investuese të huaja (24,24%), ndërsa një pjesë më e vogël në aksione të huaja (4,09%), obligacione shtetërore të huaja (2,97%) dhe letra shtetërore afatshkurtra të huaja (0,14%).

Sa i përket kthimeve, në vitin 2025 është evidentuar një rritje e moderuar e kthimit vjetor në vlerë nominale si te fondet pensionale të detyrueshme ashtu edhe te fondet pensionale vullnetare për periudhën shtatëvjeçare 2019–2025. Megjithatë, rritja e kostove të jetesës vazhdon të ketë ndikim të konsiderueshëm mbi kthimet në vlerë reale. Në nivel të shtyllës së dytë, kthimi mesatar vjetor në periudhën e përmendur ishte 5,51% në vlerë nominale dhe 0,16% në vlerë reale, ndërsa te shtylla e tretë, kthimi mesatar vjetor ishte 5,69% në vlerë nominale dhe 0,33% në vlerë reale.

Kursimi pensional është investim afatgjatë, ndërsa MAPAS do të vazhdojë të kontribuojë në forcimin e vazhdueshëm të kursimeve individuale përmes sigurimit të menaxhimit të rreziqeve që u kanosen mjeteve, pensioneve dhe kompensimeve pensionale të anëtarëve të fondeve pensionale, si dhe reputacionit të sistemit, dhe reduktimit të tyre në nivelin më të ulët të mundshëm.

Njëkohësisht, duke pasur parasysh zhvillimin intensiv teknologjik dhe transformimin digjital të sektorit financiar, MAPAS do të vazhdojë të mbështesë proceset e modernizimit dhe avancimit të shërbimeve të shoqërive pensionale, si dhe transformimin e vet digjital, me qëllim thjeshtimin dhe përmirësimin e funksionit rregullator dhe mbikëqyrës.

Si institucion rregullator dhe mbikëqyrës, MAPAS edhe më tej do të veprojë në përputhje me misionin e tij dhe do t'i orientojë aktivitetet e veta drejt avancimit të vazhdueshëm të sigurimit pensional me financim kapital, duke ndjekur parimet dhe standardet e praktikës ndërkombëtare mbikëqyrëse, të njohura dhe të konfirmuara nga Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve Pensional (IOPS).

Kryetar i Këshillit të Ekspertëve,
Remzi Bajrami

MAPAS, MISIONI DHE VIZIONI

Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional – MAPAS është institucion rregullator dhe mbikëqyrës i themeluar me qëllim që të kujdeset për interesat e anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar të fondeve pensionale dhe të nxisë zhvillimin e sigurimit pensional me financim kapital. Është themeluar në korrik të vitit 2002. Ka cilësinë e personit juridik me autorizime publike, të përcaktuara me Ligjin për sigurim pensional të detyrueshëm me financim kapital dhe me Statutin. Për punën e saj përgjigjet para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

MAPAS është përgjegjëse për lëshimin, tërheqjen dhe heqjen e licencave për themelimin e shoqërive pensionale, licencave për ushtrimin e veprimtarisë – Administrimin e fondeve pensionale dhe për lëshimin, tërheqjen dhe shfuqizimin e miratimeve për Administrimin e fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare. Ajo kryen mbikëqyrje mbi punën e shoqërive pensionale, të fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare, si dhe të ruajtësve të pasurisë dhe të menaxherëve të huaj të mjeteve. MAPAS, gjithashtu, promovon, organizon dhe nxit zhvillimin e sigurimit pensional me financim kapital në RMV, në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale dhe zhvillon vetëdijen e publikut për qëllimet dhe parimet e shoqërive pensionale dhe të fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare, për përfitimet nga anëtarësimi në fond pensional të detyrueshëm dhe/ose vullnetar, duke përfshirë edhe qëllimet, parimet dhe përfitimet nga pjesëmarrja në skemë pensionale profesionale, për të drejtat e anëtarëve të fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare dhe për çështje të tjera lidhur me sigurimin pensional me financim kapital. MAPAS miraton akte në përputhje me ligjet nga fusha e sigurimit pensional me financim kapital, si dhe udhëzime profesionale, doracakë dhe të ngjashme, lidhur me sigurimin pensional me financim kapital dhe nxit miratimin e ligjeve dhe akteve të tjera lidhur me shoqëritë pensionale dhe fondet pensionale që ato SHAministrojnë. Gjithashtu, MAPAS bashkëpunon me institucionet relevante në RMV dhe jashtë vendit me qëllim që të sigurojë kontroll efikas të sigurimit pensional me financim kapital në RMV.

Me Agjencinë për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional udhëheq Këshilli i Ekspertëve, i përbërë nga kryetari i Këshillit dhe katër anëtarë, si vijon:

- Remzi Bajrami – kryetar,
- Pranvera Suma – anëtare e angazhuar profesionalisht,
- Darko Sazdov – anëtar i angazhuar profesionalisht,
- Borçe Bozhinoski – anëtar i jashtëm,
- Marina Makenaxhieva – anëtare e jashtme.

Në seancën e mbajtur më 14 maj 2025, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi vendim me të cilin Remzi Bajrami u zgjodh kryetar i Këshillit të Ekspertëve. Deri në zgjedhjen e tij, kryetar i Këshillit të Ekspertëve ishte Maksud Ali. Më pas, në seancën e mbajtur më 16 dhjetor 2025, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi vendim me të cilin Pranvera Suma u zgjodh anëtare e Këshillit të Ekspertëve. Më parë, anëtar i Këshillit të Ekspertëve ishte Mentor Jakupi.

Misioni i MAPAS-it është të mbrojë interesat e anëtarëve dhe të anëtarëve të pensionuar të fondeve pensionale dhe të nxisë zhvillimin e sigurimit pensional me financim kapital, për ditë pensionimi më të sigurta.

Vizioni i MAPAS-it është të njihet si institucion i pavarur, profesional dhe transparent, i cili e mbron dhe e avancon sigurimin pensional me financim kapital.

1. Pasqyrë e shkurtër e gjendjeve dhe trendeve botërore në fushën pensionale me theks në sigurimin pensional me financim kapital

1. Pasqyrë e shkurtër e gjendjeve dhe trendeve botërore në fushën pensionale me theks në sigurimin pensional me financim kapital

Pas rënies së shënuar në vitin 2022, mjetet në fondet pensionale shënuan sërish rritje në vitin 2023, ndërsa trendi i rritjes vazhdoi edhe në vitin 2024, ku rritja mesatare në vendet anëtare të OECD-së ishte 7,1%. Në fund të vitit 2024, mjetet në sistemet pensionale arritën nivel rekord prej 69,8 trilionë USD në vendet anëtare të OECD-së, ndërsa në vendet që nuk janë anëtare të OECD-së ato arritën në 2,9 trilionë USD. Rritja e mjeteve pensionale në vitin 2024 përfaqëson një trend të përhapur gjerësisht pothuajse në të gjitha vendet e analizuara. Ndër vendet anëtare të OECD-së, rritja më e lartë e mjeteve është shënuar në Turqi, vendet baltike dhe Greqi, ku rritja e mjeteve ka tejkaluar 20% në vlerë nominale në valutën vendase. Rritje të mjeteve mbi 20% në vitin 2024 është evidentuar edhe në pothuajse një të tretën e vendeve të analizuara që nuk janë anëtare të OECD-së.

Rritja e vlerës së mjeteve pensionale në vitin 2024 kryesisht i atribuohet normave pozitive nominale të kthimit nga investimet. Për të dytin vit radhazi, fondet pensionale shënuan fitime nga investimet, duke realizuar norma pozitive nominale të kthimit pothuajse në të gjitha vendet e analizuara. Norma mesatare nominale e kthimit ishte 9,1% te fondet pensionale në vendet anëtare të OECD-së dhe 11,7% te fondet pensionale në vendet që nuk janë anëtare të OECD-së. Kthimet, në pjesën më të madhe, ishin mbi mesataren e tyre afatgjatë. Fondet pensionale me ekspozim më të madh ndaj investimeve në aksione realizuan fitime mjaft të mira nga investimet në vitin 2024, të nxitura nga lëvizjet pozitive në tregjet globale të kapitalit. Tregjet globale të aksioneve realizuan kthime pozitive, të nxitura nga rritja ekonomike që tejkaloi pritjet, si dhe të mbështetura më tej nga rezultatet e mira të kompanive të mëdha teknologjike të listuara në bursë në SHBA. Normat nominale të kthimit të fondeve pensionale në pjesën më të madhe të vendeve të analizuara tejkaluan inflacionin, megjithëse mesatarja në vendet që nuk janë anëtare të OECD-së (1,2%) ishte më e ulët krahasuar me vendet anëtare të OECD-së (5%), për shkak të normave më të larta të inflacionit.

Gjatë vitit 2025 u diskutua edhe për investimet infrastrukturore të fondeve pensionale. Në kushtet e detyrimeve afatgjata, projektet infrastrukturore njihen si një klasë e përshtatshme aktivesh për shkak të fluksit të tyre relativisht të qëndrueshëm dhe të parashikueshëm të mjeteve monetare. Më së shpeshti, këto investime orientohen drejt sektorëve si transporti, energjetika, telekomunikacioni dhe infrastruktura komunale, të cilët kanë rol të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik. Diskutohen modele të ndryshme investimi, si investimet e drejtpërdrejta, investimet përmes fondeve të kapitalit privat dhe partneritetet publiko-private. Njëkohësisht, theksohet se investimet infrastrukturore, përveç mundësisë për diversifikim dhe kthime më të larta, mbartin edhe rreziqe të caktuara, veçanërisht në aspektin e jolikuiditetit, pasigurisë rregullatore dhe kompleksitetit të strukturave kontraktore. Sfidë shtesë paraqet edhe vlerësimi i këtyre aktiveve, i cili shpesh bazohet në modele dhe supozime. Shumë e rëndësishme është

nevoja për transparencë më të madhe dhe standardizim në raportim. Mungesa e përkufizimeve dhe taksonomive të unifikuara për investimet infrastrukturore e kufizon krahasueshmërinë e të dhënave ndërmjet vendeve. Investimet infrastrukturore mund të kontribuojnë në diversifikim më të madh dhe qëndrueshmëri më të lartë të portofoleve pensionale, nëse mbështeten nga një kornizë e përshtatshme rregullatore, menaxhim efikas i rreziqeve dhe mbikëqyrje adekuate.

Sistemet pensionale në botë zhvillohen në forma të ndryshme, varësisht nga karakteristikat socio-ekonomike dhe demografike të shteteve, zakonet kulturore të popullsisë dhe niveli i edukimit financiar dhe gatishmërisë për kursim për pension. Në kushte moderne, hartuesit e politikave gjithnjë e më shumë orientohen drejt diversifikimit të burimeve të të ardhurave në pleqëri përmes kombinimit të modeleve të ndryshme të financimit dhe përllogaritjes së pensioneve. Në këtë drejtim, sistemet publike të financuara në mënyrë aktuale dhe sistemet private të financuara me kapital konsiderohen si mekanizma komplementarë që së bashku kontribuojnë në stabilitet dhe siguri më të madhe të të ardhurave pensionale. Këto sisteme ofrojnë zgjidhje të ndryshme për përmbushjen e objektivave bazë të sigurimit pensional dhe kanë kapacitet të ndryshëm për përballimin e rreziqeve me të cilat përballen individët gjatë ciklit jetësor, si rreziku i jetëgjatësisë, inflacioni, papunësia apo krizat ekonomike. Për këtë arsye, sfida kryesore për çdo shtet është vendosja e një ekuilibri të përshtatshëm ndërmjet komponentëve të ndryshëm të sistemit pensional, në mënyrë që ai të jetë financiarisht i qëndrueshëm, shoqërisht i drejtë dhe i përshtatshëm ndaj ndryshimeve demografike dhe ekonomike në të ardhmen. Për të përmbushur funksionet e tij bazë – sigurimin e të ardhurave dhe sigurinë sociale në pleqëri – sistemi pensional duhet njëkohësisht të jetë fiskalisht i përballueshëm në afat të shkurtër, i qëndrueshëm në afat të mesëm dhe i aftë në afat të gjatë të sigurojë nivel të përshtatshëm të të ardhurave pensionale. Përvojat deri më tani tregojnë se nuk ekziston një model universal i sistemit pensional që mund të aplikohet njësoj me sukses në të gjitha vendet. Përkundrazi, shtetet krijojnë kombinime të ndryshme të mekanizmave për financim, përllogaritje dhe pagesë të pensioneve, në përputhje me specifikat e tyre ekonomike, institucionale dhe sociale. Në praktikën bashkëkohore, pjesa më e madhe e sistemeve pensionale janë të organizuara si sisteme me shumë shtylla, me qëllim shpërndarjen dhe uljen e llojeve të ndryshme të rreziqeve. Zakonisht, kjo strukturë përfshin tre shtylla bazë: shtylla e parë – sigurimi i detyrueshëm shtetëror pensional i bazuar në financim aktual, shtylla e dytë – sigurimi pensional i detyrueshëm me financim kapital dhe shtylla e tretë – sigurimi pensional privat vullnetar. Me këtë strukturë mundësohet kombinimi i sigurisë sociale që e ofron shteti me përfitimet nga kursimi afatgjatë dhe investimi i mjeteve në tregjet financiare. Në dekSHAat e fundit, veçanërisht në kushte të plakjes së përshpejtuar të popullsisë, uljes së normës së natalitetit dhe dinamikës së ndryshueshme të tregut të punës, shumë vende po zbatojnë reforma të orientuara drejt forcimit të qëndrueshmërisë së sistemeve pensionale. Këto reforma synojnë të sigurojnë stabilitet më të mSHAh financiar të sistemeve, por edhe nivel të përshtatshëm të të ardhurave për pensionistët e ardhshëm, të përshtatura me sfidat moderne ekonomike dhe demografike.


Sipas analizave të reformave kryesore pensionale të zbatuara ose të miratuara në periudhën nga viti 1995 deri në fund të vitit 2025, në sistemet e bazuara në solidaritet gjeneracional (pay-as-you-go), shumë vende kanë ndërmarrë masa të orientuara drejt përmirësimit të

qëndrueshmërisë financiare dhe fiskale të sistemeve pensionale. Në dekSHAat e fundit, proceset reformuese janë fokusuar kryesisht në përshtatjen e parametrave të sistemeve pensionale me ndryshimet demografike dhe ekonomike. Një nga masat më të përdorura është rritja e normave të kontributeve në sistemet e solidaritetit gjeneracional, e cila është zbatuar në rreth 89 vende (mes të cilave shembuj të fundit janë Koreja e Jugut, Kazakistani dhe Ruanda). Përveç kësaj, një numër i konsiderueshëm shtetesh janë orientuar drejt rritjes graduale të moshës së pensionimit, si përgjigje ndaj rritjes së jetëgjatësisë dhe plakjes së popullsisë. Reforma të tilla janë futur në 68 vende (mes të cilave Kina, Danimarka dhe Republika Çeke). Gjithashtu, në shumë vende janë zbatuar ndryshime në formulat e llogaritjes së pensioneve, si dhe në indeksim, me qëllim kufizimin e kostove afatgjata fiskale dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë së sistemeve. Masa të tilla janë ndërmarrë në 70 vende (mes të cilave Kuba, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Republika Çeke). Në të njëjtën kohë, shumë shtete po zbatojnë politika për nxitjen e qëndrimit më të gjatë në tregun e punës, gjë që pritet të ketë ndikim pozitiv në nivelin e pensioneve të ardhshme. Përveç reformave parametrike, gjithnjë e më shumë vëmendje i kushtohet zgjerimit të përfshirjes së popullsisë në sistemet pensionale, si dhe nxitjes së pagesës së rregullt të kontributeve. Në drejtim të sigurimit të të ardhurave të përshtatshme pas pensionimit, po forcohet ndjeshëm edhe roli i sigurimit pensional me financim kapital dhe privat. Kjo realizohet përmes krijimit të fondeve të reja private pensionale, si dhe përmes reformave dhe masave të orientuara drejt përmirësimit të funksionimit, transparencës dhe efikasitetit të tyre.

Indikatorët kryesorë që reflektojnë rëndësinë e sistemeve pensionale janë përfshirja e popullsisë dhe niveli i mjeteve pensionale në sistemet pensionale. Pas rënies së vërejtur në vitin 2022, mjetet në fondet pensionale përsëri shënuan rritje në vitin 2023, ndërsa trendi i rritjes vazhdoi edhe në vitin 2024, ku rritja mesatare në vendet anëtare të OECD-së ishte 7,1%. Në fund të vitit 2024, mjetet në sistemet pensionale arritën nivel rekord prej 69,8 trilionë USD në vendet anëtare të OECD-së, ndërsa në vendet jo-anëtare të OECD-së arritën 2,9 trilionë USD. Rritja e mjeteve pensionale në vitin 2024 paraqet një trend të gjerë në pothuajse të gjitha vendet e analizuara. Ndër vendet e OECD-së, rritja më e lartë është shënuar në Turqi, vendet baltike dhe Greqi, ku rritja ka tejkaluar 20% në vlerë nominale në monedhën vendore. Rritje mbi 20% në vitin 2024 është evidentuar edhe në pothuajse një të tretën e vendeve jo-anëtare të OECD-së.

Krahasimi i madhësisë së mjeteve të pensioneve private në raport me ekonominë, të shprehur përmes BPV-së, jep një pasqyrë më të mirë të rëndësisë relative të segmentit privat pensional në një vend. Pjesëmarrja e mjeteve pensionale në BPV në vitin 2024 në shumicën e vendeve të zgjedhura është paraqitur në Grafikun 1.1. Madhësia e mjeteve të sistemeve private pensionale ndryshon nga vendi në vend, gjë që lidhet me fillimin e ndryshëm të krijimit të sistemeve, nëse përfshirja në planin pensional është e detyrueshme apo vullnetare, si dhe me rezultatet investuese. Vendet me nivelin më të lartë të mjeteve zakonisht janë ato me fonde ose plane pensionale të detyrueshme. Për shembull, në Islandë dhe Zvicër, ku punëdhënësit janë të obliguar të ofrojnë plane profesionale pensionale për punonjësit e tyre, planet pensionale zotërojnë mjete në vlerë prej 191% dhe 167% të BPV-së. Në Danimarkë dhe Holandë, ku punëdhënësit janë të obliguar të marrin pjesë në plane pensionale sipas marrëveshjeve në nivel industrie ose sektori, niveli i mjeteve është gjithashtu i lartë në raport me BPV-në. Vendet me plane vullnetare ose më të reja pensionale kanë nivele më të ulëta të mjeteve, me disa përjashtime të rëndësishme si SHBA. Në SHBA, ku kursimet për pension janë zhvilluar prej dekadash, mjetet pensionale përbëjnë më shumë se 70% të të gjitha mjeteve pensionale në vendet anëtare të OECD-së. Në vende të tjera me plane vullnetare ose të futura së fundmi, si Greqia, Hungaria dhe Turqia, mjetet pensionale janë ende të kufizuara.

Grafiku 1.1. Mjetet totale pensionale, sipas vendeve, 2024 (në % të BPV-së)




Rritja e vlerës së mjeteve pensionale në vitin 2024 kryesisht i atribuohet normave pozitive nominale të kthimit nga investimet. Për të dytin vit rSHAhazi, fondet pensionale shënojnë fitime investuese, ku u realizuan norma pozitive nominale të kthimit në pothuajse të gjitha vendet e analizuara. Norma mesatare nominale e kthimit ishte 9,1% te fondet pensionale në vendet anëtare të OECD-së dhe 11,7% te fondet pensionale në vendet joanëtare të OECD-së. Kthimet në pjesën më të madhe ishin mbi mesataren e tyre afatgjatë.

Fondet pensionale me ekspozim më të mSHAh në investime në aksione realizuan fitime relativisht të mira investuese në vitin 2024, të nxitura nga lëvizjet pozitive në tregjet globale të kapitalit. Tregjet globale të aksioneve shënuan kthime pozitive, të mbështetura nga rritja ekonomike që i tejkaloi pritjet, si dhe nga rezultatet e mira të kompanive të mëdha teknologjike të listuara në SHBA. Indeksi botëror MSCI në vitin 2024 u rrit për gati 20%. Vlera e indekseve bursiere u rrit në pjesën më të madhe të bursave në vendet anëtare të OECD-së, ku ndër rezultatet më të mira u shënuan në disa nga tregjet më të mëdha (për shembull: 23,8% te indeksi S&P 500 në SHBA, 19,2% te Nikkei-225 në Japoni dhe 18,8% te DAX në Gjermani). Fondet pensionale në fund të vitit 2024 mbanin një pjesë më të madhe të aksioneve krahasuar me vitin paraprak, si rezultat i rritjes së vlerës së aksioneve në portofolet e tyre ose për shkak të rishpërndarjes aktive të mjeteve drejt investimeve në aksione.

Normat nominale të kthimit të fondeve pensionale në pjesën më të madhe të vendeve të analizuara e tejkaluan inflacionin, megjithëse mesatarja te vendet joanëtare të OECD-së (1,2%) ishte më e ulët krahasuar me vendet anëtare të OECD-së (5%), për shkak të normave më të larta të inflacionit. Fondet pensionale nuk arritën të realizojnë kthime reale

pozitive vetëm në 7 nga gjithsej 69 vende, pavarësisht normave pozitive nominale të kthimit, të cilat nuk ishin të mjaftueshme për të kompensuar inflacionin e lartë (për shembull: Angola, Nigeria, Turqia dhe Zimbabve). Në Grafikun 1.2 janë paraqitur normat nominale dhe reale të kthimit investues të mjeteve pensionale në dhjetor 2023 – dhjetor 2024, në vende të zgjedhura anëtare të OECD-së dhe vende të zgjedhura joanëtare të OECD-së.

Grafiku 1.2. Norma nominale dhe reale e kthimit investues (IRR) e mjeteve pensionale, dhjetor 2023 – dhjetor 2024, në %



Performancat investuese të fondeve pensionale në afat të gjatë janë më të rëndësishme se fitimet ose humbjet afatshkurtra, pasi fondet pensionale janë investitorë afatgjatë. Luhatjet në rezultatet e investimeve janë të pashmangshme gjatë jetës së një portofoli pensional. Fondet pensionale kanë realizuar fitime investuese në afat të gjatë, duke kontribuar në rritjen nominale të mjeteve të destinuara për pension. Pavarësisht disa viteve me rezultate të dobëta ose negative investuese, si 2008, 2011, 2018 dhe 2022, kthimet reale në afat më të gjatë (në 10, 15 dhe 20 vitet e fundit) kanë qenë pozitive në shumicën e vendeve. Fitimet relativisht të larta investuese në vitin 2024 kontribuan në zbutjen e rezultateve negative të vitit 2022, megjithëse ato nuk ishin mjaftueshëm të larta për t'i kompensuar plotësisht në afat të shkurtër. Fitimet reale në vitin 2024 nuk ishin të mjaftueshme për të kompensuar rezultatet negative të pesë viteve të fundit në shumicën e vendeve anëtare të OECD-së (21 nga 33 vende), si dhe në më shumë vende joanëtare të OECD-së (14 nga 30), duke pasur parasysh rënien e konsiderueshme në vitin 2022.

Faktorët mjedisorë, socialë dhe të qeverisjes (ESG faktorët) janë çështje kyçe për investimin dhe menaxhimin e rrezikut të fondeve pensionale, ndërsa integrimi i tyre në kornizat rregullatore të sistemeve pensionale në mbarë botën është relativisht i ri. ESG faktorët zhvillohen në mënyrë dinamike dhe kanë ndikime dhe rreziqe të ndryshme në varësi të vendit. Pikërisht për këtë arsye, gjatë viteve të fundit kjo temë është diskutuar gjerësisht dhe në vitin 2019, IOPS, në bazë të hulumtimeve dhe analizave, ka përcaktuar udhëzime për mbikëqyrje lidhur me integrimin e ESG faktorëve në investime dhe në menaxhimin e rrezikut të fondeve pensionale. Udhëzimet nxisin mbikëqyrësit të sigurojnë që integrimi eksplicit i faktorëve socialë, etikë dhe mjedisorë në procesin e investimit dhe në procesin e menaxhimit të rrezikut të jetë në përputhje me detyrimin fiduciar të menaxherëve dhe propozojnë transparencë të shtuar dhe publikim të këtyre faktorëve nga ana e menaxherëve të mjeteve pensionale. Këto udhëzime janë jo detyruese dhe shërbejnë si udhërrëfyes për mbikëqyrësit pensionalë. Mbikëqyrësit mund t'i zbatojnë ato në përputhje me strukturën e sistemit të tyre pensional dhe rregullativën. Që nga viti 2021, IOPS ka diskutuar edhe udhëzime për zbatimin që ndihmojnë mbikëqyrësit në vendet anëtare të IOPS në aplikimin e udhëzimeve të mbikëqyrjes lidhur me integrimin e ESG faktorëve. Në vitin 2025, IOPS prezantoi këto udhëzime që përmbajnë një pasqyrë të praktikave dhe rregullave të aplikuara nga organet mbikëqyrëse në sektorin pensional, si dhe në sektorë të tjerë, të cilat mund të jenë të dobishme për integrimin e ESG faktorëve në proceset investuese dhe në menaxhimin e rrezikut te fondet pensionale dhe skemat pensionale. Një pjesë e madhe e shembujve të përmendur janë në përputhje me udhëzimet e IOPS, megjithëse disa praktika ndryshojnë në nivelin e ashpërsisë dhe konsistencës. Qëllimi i dokumentit nuk është të vendosë udhëzime të reja, por të ofrojë një pasqyrë të praktikave ekzistuese dhe zgjidhjeve rregullatore me qëllim lehtësimin e zbatimit të udhëzimeve të IOPS në fushën e ESG faktorëve.

Në vitin 2025 u diskutuan edhe investimet infrastrukturore të fondeve pensionale. Në kushte të detyrimeve afatgjata, projektet infrastrukturore njihen si klasë e përshtatshme asetesh për shkak të rrjedhës së tyre relativisht të qëndrueshme dhe të parashikueshme të parasë. Më së shpeshti, këto investime janë të orientuara në sektorë si transporti, energjetika, telekomunikacioni dhe infrastruktura komunale, të cilët kanë rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik. Diskutohen modele të ndryshme investimi, si investimet direkte, investimet përmes fondeve të kapitalit privat dhe partneritetet publiko-private. Njëkohësisht, theksohet se investimet infrastrukturore, përveç mundësisë për diversifikim dhe kthime më të larta, bartin edhe rreziqe të caktuara, veçanërisht në lidhje me mungesën e likuiditetit, pasigurinë rregullatore dhe kompleksitetin e strukturave kontraktuale. Një sfidë shtesë është edhe vlerësimi i këtyre aseteve, i cili shpesh bazohet në modele dhe supozime. Shumë e rëndësishme është nevoja për transparencë më të madhe dhe standardizim në raportim. Mungesa e përkufizimeve dhe taksonomive të unifikuara për investimet infrastrukturore e kufizon krahasueshmërinë e të dhënave midis vendeve. Në këtë drejtim, rekomandohet harmonizimi me standardet ndërkombëtare dhe përfshirja e ESG faktorëve në procesin e investimit, me theks të veçantë në rreziqet klimatike dhe qëndrueshmërinë e projekteve. Investimet infrastrukturore mund të kontribuojnë në diversifikim më të mSHAh dhe reziliencë të portofoleve pensionale, nëse mbështeten me kornizë të përshtatshme rregullatore, menaxhim efikas të rrezikut dhe mbikëqyrje SHAekuate.

Në nëntor 2025 u rishikuan udhëzimet e IOPS për vlerësimin mbikëqyrës të fondeve pensionale. Ato përbëjnë një kornizë të përditësuar dhe të zgjeruar për vlerësimin mbikëqyrës të fondeve pensionale, me qëllim përmirësimin e cilësisë së mbikëqyrjes dhe forcimin e stabilitetit të sistemeve pensionale. Dokumenti thekson rolin kyç të mbikëqyrësve në sigurimin e sigurisë

së mjeteve të anëtarëve, qëndrueshmërisë së skemave pensionale dhe ruajtjes së besimit në sektorin pensional. Në kushte të rritjes së volatilitetit të tregut, presioneve demografike dhe strategjive gjithnjë e më komplekse investuese, nevoja për mbikëqyrje efikase të bazuar në rrezik bëhet veçanërisht e rëndësishme. Udhëzimet vendosin një qasje sistematike ndaj vlerësimit mbikëqyrës, që përfshin monitorim të rregullt dhe kontrolle të detajuara. Monitorimi i rregullt nënkupton mbledhje dhe analizë të vazhdueshme të të dhënave financiare, investuese dhe aktuare, me qëllim identifikimin në kohë të rreziqeve potenciale. Kontrollet mundësojnë vlerësim më të thelluar të strukturës organizative, sistemeve të qeverisjes, kontrollit të brendshëm dhe proceseve të menaxhimit të rrezikut. Vëmendje e veçantë i kushtohet vlerësimit të bordeve drejtuese dhe aftësisë së tyre për të marrë vendime të informuara dhe të përgjegjshme në interes të anëtarëve. Kyçe është zbatimi i qasjes së bazuar në rrezik, ku burimet mbikëqyrëse orientohen drejt subjekteve dhe fushave me potencialin më të lartë të rrezikut. Në udhëzime identifikohen disa kategori rreziku, përfshirë rrezikun investues, kreditor, të likuiditetit, operativ dhe IT, si dhe rreziqet e lidhura me ofruesit e jashtëm të shërbimeve. Gjithashtu, theksohet nevoja për integrimin e rreziqeve klimatike dhe ESG në analizën mbikëqyrëse, duke pasur parasysh rëndësinë e tyre në rritje. Po ashtu, theksohet roli i digjitalizimit dhe mjeteve analitike në mbikëqyrjen moderne. Përdorimi i sistemeve të avancuara për përpunimin dhe analizën e të dhënave mundëson monitorim më efikas të trendeve dhe reagim më të shpejtë ndaj goditjeve potenciale të tregut. Me këto udhëzime të rishikuara vendoset një kornizë moderne dhe fleksibile për mbikëqyrje, e orientuar drejt një mbikëqyrjeje proaktive, proporcionale dhe transparente, me qëllim sigurimin e stabilitetit dhe qëndrueshmërisë afatgjatë të fondeve pensionale.

2. Struktura e sigurimit pensional me financim kapital në Republikën e Maqedonisë së Veriut

2.1. Përshkrimi i sistemit pensional

Sistemi pensional i Maqedonisë përfaqëson një sistem të kombinuar të sigurimit pensional publik, të financuar sipas parimit të financimit rrjedhës, dhe të sigurimit pensional privat me financim kapital. Sigurimi pensional me financim kapital bazohet në parimin e kapitalizimit të kontributeve të paguara në emër dhe për llogari të anëtarit. Karakteristikë e këtij sigurimi është se mjetet në të administrohen në mënyrë private dhe konkurruese nga shoqëritë pensionale. Tiparet e rëndësishme të sigurimit pensional me financim kapital janë e drejta për zgjedhje personale, e drejta për transferueshmërinë e mjeteve, si dhe sigurimi i një niveli të lartë transparence.

Në RMV, në vitin 2025, ekzistojnë katër shoqëri pensionale, prej të cilave tri administrojnë nga një fond pensional të detyrueshëm dhe nga një fond pensional vullnetar, ndërsa një shoqëri pensionale administron një fond pensional vullnetar.

Sistemi pensional maqedonas është pjesë e sigurimeve shoqërore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (RMV) dhe ka strukturën e mëposhtme:

- Sigurimi në bazë të solidaritetit gjeneracional (i ashtuquajturi shtylla e parë),
- Sigurimi i detyrueshëm pensional me financim kapital (i ashtuquajturi shtylla e dytë),
- Sigurimi vullnetar pensional me financim kapital (i ashtuquajturi shtylla e tretë).

Kjo strukturë është rezultat i reformës së thellë të sistemit pensional, e cila është përgatitur gjatë disa viteve, ndërsa korniza e saj ligjore është vendosur në vitin 2000. Ekzistojnë katër ligje dhe një numër i mSHAh aktesh nënligjore që e rregullojnë sistemin pensional në RMV. Ato janë: Ligji për sigurimin pensional dhe invalidor, Ligji për sigurimin e detyrueshëm pensional me financim kapital, Ligji për sigurimin vullnetar pensional me financim kapital, Ligji për pagesën e pensioneve dhe kompensimeve pensionale nga sigurimi pensional me financim kapital, si dhe një numër i mSHAh aktesh nënligjore që e rregullojnë më tej këtë fushë.

Sistemi pensional në RMV ka një histori të gjatë ekzistence, përfshirje të gjerë të fuqisë punëtore dhe sigurim pensionesh për personat e siguruar. Megjithatë, ndryshimet socio-ekonomike në RMV në fillim të viteve 90 ndikuan në sistemin pensional, i cili u përball me vështirësi financiare në funksionimin e tij. Ato u shkaktuan nga lëvizjet e pafavorshme në ekonomi që ndikuan në uljen e numrit të të siguruarve aktivë dhe në uljen e mbledhjes së kontributeve, nga njëra anë, dhe rritjen e numrit të pensionistëve, nga ana tjetër. Shpenzimet për pensione shënonin rritje të vazhdueshme.

Një faktor tjetër me ndikim të fortë në sistemin pensional është faktori demografik. Përkatësisht, plakja e popullsisë, e cila është trend botëror, nënkupton që njerëzit jetojnë gjithnjë e më gjatë për shkak të kushteve më të mira të jetesës dhe shërbimeve shëndetësore më të mira, ndërsa njëkohësisht zvogëlohet numri i të lindurve, përkatësisht i të rinjve. Si rezultat i këtij faktori, pjesëmarrja e personave të moshuar në popullsinë e përgjithshme është gjithnjë e më e madhe.

Këto lëvizje demografike në sistemin pensional shkaktojnë rritje të numrit të pensionistëve dhe përdorim më të gjatë të pensionit, si dhe ulje të numrit të të siguruarve. Për një sistem me financim

të vazhdueshëm, shumë i rëndësishëm është raporti midis të siguruarve dhe pensionistëve, pasi me kontributet e të siguruarve aktualë paguhen pensionet e pensionistëve aktualë. Projektimet aktuare, të bëra gjatë përgatitjes së reformës së sistemit pensional, treguan se këta faktorë mund të kenë ndikim të mSHAh negativ në solvencën e Fondit të SPIMV-së në afat të gjatë, përkatësisht, pa reforma, sistemi do të funksiononte me deficit të theksuar që do të rritej shpejt dhe ndjeshëm.

Me qëllim të përballimit të këtyre gjendjeve të pritshme, u realizua një reformë e thellë e sigurimit pensional dhe invalidor në vendin tonë, me të cilën u vendos sistemi pensional me tre shtylla, me mënyrë të kombinuar të financimit të pensioneve të ardhshme dhe me diversifikim të rreziqeve demografike dhe ekonomike, me qëllim sigurimin e një pensioni të sigurt për gjeneratat aktuale dhe të ardhshme të pensionistëve dhe stabilitet afatgjatë financiar të sistemit pensional.

Shtylla e parë financohet mbi bazë të vazhdueshme (PAYG), që do të thotë se me kontributet e të siguruarve aktualë paguhen pensionet e pensionistëve aktualë. Kjo shtyllë funksionon mbi parimin e pensioneve të përcaktuara, përkatësisht përmes saj sigurohen pensione sipas një formule të përcaktuar paraprakisht për llogaritjen e pensionit. Nga shtylla e parë paguhet një pjesë e pensionit të pleqërisë, pensionit invalidor, pensionit familjar, si dhe shuma më e ulët e pensionit.

Shtylla e dytë dhe e tretë përfaqësojnë sigurim pensional me financim kapital, në të cilin bëhet kapitalizimi i kontributeve të paguara në emër dhe për llogari të anëtarit. Këto dy shtylla funksionojnë mbi parimin e kontributeve të përcaktuara, përkatësisht në to niveli i kontributit që paguhet është i përcaktuar paraprakisht, ndërsa pensioni përcaktohet më vonë, në varësi të shumës së akumuluar. Nga shtylla e dytë paguhet një pjesë e pensionit të pleqërisë. Nga shtylla e tretë sigurohet mbrojtje financiare/kompensim gjatë pleqërisë, invaliditetit dhe në rast të vdekjes së të siguruarit.

Me vendosjen e sistemit pensional me shumë shtylla si sistem i kombinuar nga sigurimi publik me financim të vazhdueshëm dhe sigurimi privat me financim kapital në RMV, pritet të sigurohet stabilitet afatgjatë i sistemit dhe siguri në realizimin e të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor, përmes përfitimeve afatgjata për individët që marrin pjesë në sistemin pensional, për vetë sistemin pensional, si dhe efekte shtesë në ekonomi. Nga aspekti i individëve, sigurohet më shumë siguri në realizimin e pensionit që financohet nga më shumë burime, duke bërë shpërndarje të rreziqeve. Njëkohësisht, me reformën arrihet transparencë dhe informim më i mSHAh i anëtarëve të fondeve pensionale. Reforma duhet të çojë drejt një sistemi pensional solvent, si dhe rritje të kursimeve dhe nxitje të investimeve të popullsisë dhe rritjes ekonomike.
.

2.2 Roli i sigurimit pensional me financim kapital në sistemin pensional

Sigurimi pensional me financim kapital dallon rrënjësisht nga sigurimi pensional i financuar aktualisht si në pikëpamje të trajtimit dhe evidencës së kontributeve të paguara, ashtu edhe në pikëpamje të përcaktimit dhe pagesës së pensionit. Në këtë sigurim, çdo anëtar ka një llogari individuale në të cilën evidentohen mjetet e tij dhe sigurohet një lidhje e ngushtë dhe varësi midis vëllimit të kontributeve të paguara dhe pensioneve të ardhshme që do të realizojë secili person. Kjo mënyrë e sigurimit bazohet në parimin e akumulimit të mjeteve nga kontributet në llogari individuale, të cilat më tej investohen, dhe kthimi i realizuar nga investimet, i zbritur për shpenzimet e punës së sistemit, i shtohet plotësisht mjeteve të akumuluara në llogaritë individuale. Pensioni i ardhshëm varet nga mjetet e akumuluara në llogarinë individuale dhe nga jetëgjatësia e pritshme në momentin e pensionimit, respektivisht periudha e pritshme e shfrytëzimit të pensionit. Është e rëndësishme të theksohet se ky kursim pensional është një kursim afatgjatë, gjatë të cilit ndodh një rritje grSHAuale por e vazhdueshme e kursimeve, për shkak të së cilës, në fillim, derisa i siguruari është i ri, kursimet janë të vogla, por në të ardhmen, kur i siguruari të arrijë moshën e pensionimit, kursimet bëhen dukshëm më të mëdha.

Karakteristike për këtë sigurim është se mjetet në të SHAministrohen në mënyrë private dhe konkurruese, kështu që kontributet e paguara investohen nga ana e shoqërive pensionale të licencuara dhe të specializuara që SHAministrojnë fonde pensionale. Në këtë mënyrë, sigurohet që qëllimet ekonomike të përcaktojnë strategjinë e investimit, duke krijuar mundësi për maksimizimin e kthimit të përgjithshëm në interes të anëtarëve. Diversifikimi i rreziqeve të investimeve (përfshirë edhe diversifikimin ndërkombëtar) është një nga karakteristikat më të rëndësishme të këtij sistemi.

Më tej, veçori të rëndësishme të sigurimit pensional me financim kapital janë e drejta e zgjedhjes personale dhe iniciativa e personit individual. Të gjithë të punësuarve, para 1 janarit 2003, iu dha mundësia të vendosin nëse do të përfshihen në shtyllën e dytë të sistemit pensional dhe të zgjedhin se në cilin fond pensional të detyrueshëm dëshirojnë të anëtarësohen, ndërsa të gjithë personat e sapopunësuar pas 1 janarit 2003 patën mundësinë të zgjedhin një fond pensional të detyrueshëm sipas zgjedhjes së tyre personale. Gjithashtu, me ndryshimet e Ligjit për sigurimin pensional të detyrueshëm me financim kapital nga dhjetori i vitit 2018, anëtarëve të fondeve pensionale të detyrueshme që u përfshinë vullnetarisht në shtyllën e dytë (të punësuar për herë të parë para 1.1.2003) dhe që kanë lindur para 1.1.1967, iu dha mundësia të zgjedhin të ndërpresin ose të vazhdojnë anëtarësinë në shtyllën e dytë pensionale. Të gjithë personat e sapopunësuar pas 1 janarit 2019, të cilët në datën e qasjes në sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor janë në moshë më të vogël se 40 vjeç, kanë mundësinë të zgjedhin një fond pensional të detyrueshëm sipas zgjedhjes së tyre personale. Pastaj, anëtarësimi në fonde pensionale vullnetare është sipas zgjedhjes personale të personit individual ose përmes pjesëmarrjes në një skemë pensionale profesionale, të financuar nga ana e punëdhënësit ose nga ndonjë shoqatë qytetarësh.

Bartshmëria (portabiliteti) e mjeteve është, gjithashtu, një e drejtë e rëndësishme në një sistem të sigurimit pensional me financim kapital. Të gjithë anëtarët, e një fondi pensional të detyrueshëm ose vullnetar, kanë të drejtën e kalimit nga njëri fond pensional në tjetrin, me çkat transferohen edhe mjetet e tyre të kursyera. Edhe në rast të pjesëmarrjes në një skemë pensionale profesionale, personi ka të drejtë, gjatë kalimit te një sigurues tjetër, t'i transferojë mjetet e kursyera ose në një skemë tjetër pensionale profesionale ose në një llowari individuale vullnetare.

Sigurimi pensional me financim kapital ofron një shkallë të lartë të transparencës, gjë që përfaqëson një nga karakteristikat e tij më të rëndësishme dhe një risi të dobishme në sistemin pensional. Shoqëritë kanë detyrim ligjor që, të paktën një herë në vit, t'i informojnë në formë të shkruar anëtarët dhe anëtarët e pensionuar të fondit pensional mbi gjendjen e mjeteve në llogaritë e tyre individuale, duke u dorëzuar të ashtuquajturën "zarf i gjelbër", me raportin për kursimin pensional. Zarfi i gjelbër, gjithashtu, përmban të dhëna për investimin e fondit pensional, për komisionet e llogaritura dhe për kthimin e realizuar të fondit pensional.

2.3 Institucionet në sigurimin pensional me financim kapital

Institucionet që marrin pjesë në sistemin pensional me tri shtylla janë:

- · Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë – kompetente për krijimin dhe udhëheqjen e politikës së sigurimit pensional dhe invalidor dhe për kryerjen e mbikëqyrjes në zbatimin e ligjshmërisë së këtij sigurimi.

- MAPAS – Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional – institucion rregullator dhe mbikëqyrës në sigurimin pensional me financim kapital. MAPAS llogarit komision nga shoqëritë pensionale, i cili llogaritet si përqindje nga kontributet e paguara në fondet pensionale. Për periudhën nga 1.1.2025 deri më 30.11.2025, kjo përqindje ishte 0,7%. Për periudhën nga 1.12.2025 deri më 31.12.2025, kjo përqindje ishte 0,6%.
- · Shoqëria pensionale – shoqëri aksionare, e themeluar nga institucione financiare me kapital të madh dhe përvojë, veprimtaria e vetme e së cilës është administrimi i mjeteve të fondeve pensionale. In sistemin pensional të reformuar ka mundësi për themelimin e tre llojeve të shoqërive: o Shoqëri për Administrimin e fondeve pensionale të detyrueshme, o Shoqëri për Administrimin e fondeve pensionale vullnetare, o Shoqëri për administrimin e fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare.

- Kujdestari i pasurisë së fondit pensional – ruan në mënyrë të sigurt mjetet e fondit pensional në llogari të veçantë, të ndara nga mjetet e shoqërisë.

- DAP – Drejtoria e të Ardhurave Publike – kryen vjeljen e centralizuar të kontributeve dhe deri te Fondi i SPIMV-së – Fondi i sigurimit pensional dhe invalidor i Maqedonisë së Veriut i dërgon kontributet e përgjithshme për sigurim pensional dhe invalidor.

- Fondi i SPIMV-së – Fondi i sigurimit pensional dhe invalidor i Maqedonisë së Veriut bën shpërndarjen e kontributeve për sigurim pensional midis shtyllës së parë dhe shtyllës së dytë dhe bën bartjen e kontributeve dhe të dhënave përkatëse për anëtarët, në fondet pensionale të detyrueshme të zgjedhura nga shtylla e dytë. Çdo shoqëri që Administron fond pensional të detyrueshëm ka detyrimin të paguajë komision mujor ndaj Fondi i SPIMV-së – Fondi i sigurimit pensional dhe invalidor i Maqedonisë së Veriut në vlerë prej 0,1% nga çdo kontribut i paguar në muajin paraprak në fondin pensional të detyrueshëm me të cilin Administron.

Shoqëria pensionale është shoqëri aksionare që themelohet dhe punon në përputhje me Ligjin për shoqëritë tregtare dhe Ligjin për sigurimin pensional de detyrueshëm me financim kapital, ose me Ligjin për sigurimin pensional vullnetar me financim kapital. Shoqëria pensionale themelohet në bazë të lejes nga MAPAS – Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional dhe Administron me fond pensional në bazë të aprovimit për Administrim me fond pensional. Shoqëria për Administrimin e fondeve pensionale të detyrueshme themelohet dhe Administron

Duke filluar nga prilli i vitit 2019, të siguruarit shpërndahen në tre fonde pensionale të detyrueshme, pasi më 1.4.2019 filloi punën fondi pensional i detyrueshëm TRIGLAVz. Nga maji i vitit 2022 ka skaduar periudha e mbështetjes për punën e një fondi të ri pensional të detyrueshëm në lidhje cu shpërndarjen e të siguruarve sipas dispozitave të rregullativës. Duke pasur parasysh faktin se, edhe në vitin 2025, të tria shoqëritë pensionale kanë arkëtuar komision nga kontributet në lartësi të njëjtë, në vlerat e ponderit më së shumti kanë ndikuar vlerat e kthimeve të realizuara të fondeve pensionale të detyrueshme. Në vitin 2025, ponderi i TRIGLAVz është më i vogël në raport me SAVAz dhe BKPz sepse kthimi i TRIGLAVz në këtë periudhë ishte më i ulët. Gjithashtu, gjatë gjithë vitit 2025, vlera e ponderit të BKPz është pak më e madhe (mesatarisht për një pikë përqindjeje) në raport cu vlerën e ponderit të SAVAz.

Numri i përgjithshëm i anëtarëve dhe i të siguruarve të shpërndarë përkohësisht në fondet pensionale të detyrueshme në vitin 2025 është rritur pothuajse njëjtë si vitin e kaluar, gjegjësisht për 3,20% në raport me vitin 2024. Me këtë, duke përfunduar me 31 dhjetor 2025, numri i përgjithshëm i anëtarëve dhe i të siguruarve të shpërndarë përkohësisht në fondet pensionale të detyrueshme arrin në 630.396. Sa i përket shpërndarjes së anëtarësisë sipas fondeve pensionale të detyrueshme, edhe në vitin 2025 numri më i madh i të siguruarve janë anëtarë të SAVAz and BKPz. Domethënë, nga numri i përgjithshëm i anëtarëve dhe i të siguruarve të shpërndarë përkohësisht sipas fondeve pensionale të detyrueshme, me gjendje më 31.12.2025, 45,47% janë në BKPz, 42,18% janë në SAVAz dhe 12,35% janë në TRIGLAVz. Me këtë rast, në raport me vitin 2024, vërehet një pjesëmarrje më e ulët në përqindje e anëtarësisë në SAVAz dhe në BKPz (për rreth një pikë përqindjeje), gjegjësisht një pjesëmarrje më e lartë në përqindje e anëtarësisë në TRIGLAVz (për rreth një pikë përqindjeje).


Nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të shtyllës së dytë, 61.261 ose 10% janë anëtarë vullnetarë, ndërsa 569.135 ose 90% janë anëtarë të detyrueshëm. Nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të detyrueshëm, 206.157 anëtarë kanë nënshkruar kontratë anëtarësimi, 330.797 nuk kanë nënshkruar kontratë dhe janë të shpërndarë përgjithmonë, ndërsa 32.181 të siguruar janë të shpërndarë përkohësisht. Në vitin 2025 vërehet një rënie e numrit të të siguruarve të rinj që nënshkruajnë kontrata anëtarësimi në raport me vitin e kaluar. Domethënë, rreth 11% e të siguruarve që kanë detyrim të anëtarësohen në një fond pensional të detyrueshëm në vitin 2025 dhe për të cilët ka skaduar afati për përzgjedhjen e fondit pensional të detyrueshëm, kanë nënshkruar kontratë anëtarësimi, ndërsa të tjerët, rreth 89%, nuk kanë nënshkruar kontratë dhe kanë mbetur në fondin ku kanë qenë të shpërndarë paraprakisht.

Në strukturën e anëtarëve dhe të të siguruarve të shpërndarë përkohësisht sipas statusit të anëtarësimit, në vitin 2025, për SAVAz dhe BKPz nuk kanë ndodhur ndryshime të papritura apo të rëndësishme. Struktura e anëtarëve dhe e të siguruarve të shpërndarë përkohësisht sipas statusit të anëtarësimit, në vitin 2025, është e ngjashme te SAVAz and BKPz. Me këtë rast, mund të vërehet se në çdo tremujor, pjesëmarrja në përqindje e anëtarëve vullnetarë gradualisht bie, ndërsa pjesëmarrja e anëtarëve të detyrueshëm rritet, gjë që është edhe e pritshme, pasi çdo vit rritet prurja e anëtarëve të detyrueshëm. Po ashtu, mund të vërehet se pjesëmarrja në përqindje e anëtarëve të detyrueshëm

që kanë nënshkruar kontratë anëtarësimi dhe pjesëmarrja e anëtarëve të detyrueshëm që janë të shpërndarë përgjithmonë, mbetet pothuajse në të njëjtin nivel gjatë vitit.


Pas një pune prej më shumë se gjashtë vjetësh, struktura e anëtarëve dhe e të siguruarve të shpërndarë përkohësisht sipas statusit të anëtarësimit të TRIGLAVz ende ndryshon nga struktura e SAVAz dhe BKPz. Pjesëmarrja e anëtarëve vullnetarë te TRIGLAVz është më e vogël në raport me pjesëmarrjen e anëtarëve vullnetarë te SAVAz dhe BKPz, ndërsa pjesëmarrja e të siguruarve të shpërndarë përkohësisht te TRIGLAVz është më e madhe në raport me pjesëmarrjen e të siguruarve të shpërndarë përkohësisht te SAVAz dhe BKPz. Anëtarët vullnetarë në TRIGLAVz janë të siguruar që kanë nënshkruar kontrata për kalim nga SAVAz ose BKPz në TRIGLAVz. Gjithashtu, mund të vërehet se pjesëmarrja në përqindje e anëtarëve të detyrueshëm që kanë nënshkruar kontratë anëtarësimi ka rënë paksa, për dallim nga pjesëmarrja e anëtarëve të detyrueshëm që janë të shpërndarë përgjithmonë, e cila është rritur paksa gjatë vitit. Struktura e anëtarëve dhe e të siguruarve të shpërndarë përkohësisht sipas fondeve pensionale të detyrueshme dhe sipas statusit të anëtarësimit në vitin 2025 është paraqitur në nivel tremujor, në grafikun 5.2.

Grafiku 5.2. Struktura e anëtarëve dhe e të siguruarve të shpërndarë përkohësisht sipas statusit të anëtarësimit dhe FPD-ve




Analiza e strukturës së anëtarëve sipas moshës tregon se anëtarët, në numrin më të madh, janë persona të rinj. Anëtarët e detyrueshëm janë persona të moshës së re, ku 65% e anëtarëve të detyrueshëm janë të moshës deri në 40 vjeç, ndërsa anëtarët vullnetarë janë pak më të moshuar dhe 45% prej tyre janë të moshës deri në 50 vjeç. Mosha mesatare e anëtarëve të detyrueshëm është 37 vjeç (si për burrat ashtu edhe për gratë), e anëtarëve vullnetarë është 51 vjeç (si për burrat ashtu edhe për gratë), ndërsa e të gjithë anëtarëve, gjithsej, është 38 vjeç. Struktura e anëtarëve të sistemit pensional me dy shtylla sipas moshës, gjinisë dhe kategorisë së anëtarësimit është paraqitur në grafikun 5.3.

Grafiku 5.3. Struktura e anëtarëve të sistemit pensional me dy shtylla sipas moshës, gjinisë dhe kategorisë së anëtarësimit



Sipas të dhënave të ESHS-së, në fund të vitit 2025, numri i përgjithshëm i popullsisë së aftë për punë në RMV arrin në 1.517.408, ndërsa gjithsej popullsia aktive arrin në 796.399. Me gjendje në fund të vitit 2025, rreth 42% e popullsisë së përgjithshme të aftë për punë në RMV janë anëtarë të sistemit me dy shtylla, gjegjësisht rreth 79% e popullsisë së përgjithshme aktive në RMV janë anëtarë të sistemit pensional me dy shtylla. Rritja e pjesëmarrjes së anëtarëve të sistemit pensional me dy shtylla në gjithsej popullsinë e aftë për punë dhe popullsinë aktive në RMV, për periudhën nga viti 2017 deri në vitin 2025, është paraqitur në grafikun 5.4.


Grafiku 5.4. Pjesëmarrja e anëtarëve të sistemit pensional me dy shtylla në gjithsej popullsinë e aftë për punë dhe popullsinë aktive, sipas viteve, 2017-2025




[5]*Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës – Popullsia aktive në RMV, Rezultatet nga Anketa e fuqisë punëtore, viti 2025.*
[6]*Popullsia e aftë për punë - përbëhet nga të gjithë personat e moshës prej 15 deri në 79 vjeç.*
[7]*Popullsia ekonomikisht aktive - përbëhet nga personat e punësuar dhe personat e papunë.*
[8]*Sipas ligjit, ndërprerja e pagesës së kontributit nuk ndikon në statusin e anëtarësimit në fondin pensional të detyrueshëm. Rreth 70% e numrit të përgjithshëm të të siguruarve në Fondin e SPIMV-së janë anëtarë të sistemit pensional me dy shtylla, të cilët kanë pasur të paktën një pagesë në fond pensional të detyrueshëm në vitin 2025.*

Sipas të dhënave të Fondit të SPIMV-së për numrin e të siguruarve duke përfunduar me 31.12.2025, numri i përgjithshëm i anëtarëve në fondet pensionale të detyrueshme është më i madh se numri i përgjithshëm i të siguruarve në Fondin të SPIMV-së. Në grafikun 5.5. mund të shihet rritja e pjesëmarrjes së anëtarëve të sistemit pensional me dy shtylla në numrin e përgjithshëm të të siguruarve në Fondin e SPIMV-së që nga fillimi i punës së shtyllës së dytë.

Grafiku 5.5. Pjesëmarrja e anëtarëve të sistemit pensional me dy shtylla në numrin e të siguruarve në Fondin e SPIMV-së, sipas viteve, 2006-2025



Grafiku 5.6. Struktura e anëtarëve në shtyllën e dytë, sipas rajoneve statistikore



Struktura e anëtarëve në fondet pensionale të detyrueshme, sipas rajoneve statistikore në RMV, është dhënë në grafikun 5.6. Numrin më të madh të anëtarëve edhe në të tria fondet pensionale të detyrueshme e ka Rajoni i Shkupit. Numrin më të vogël të anëtarëve në SAVAz e ka Rajoni Verilindor, ndërsa numrin më të vogël të anëtarëve në BKPz dhe në TRIGLAVz e ka Rajoni Juglindor.

[9]Rajonet statisticore janë të përcaktuara sipas ESHS-së – njësitë territoriale. Nomenklatura e njësive territoriale bazohet në organizimin territorial të vetëmenaxhimit lokal në RMV dhe është e harmonizuar me klasifikimin e BE-së.

[10]MAPAS-i nuk disponon me të dhëna për rajonin statistikor për të gjithë anëtarët e fondeve pensionale të detyrueshme, për shkak se pjesa më e madhe e anëtarëve nuk kanë nënshkruar kontratë anëtarësimi dhe janë të shpërndarë përgjithmonë

5.3. Kalimi i anëtarit nga njëri në fondin tjetër pensional të detyrueshëm

Çdo anëtar i një fondi pensional të detyrueshëm ka të drejtë të kalojë në një fond tjetër pensional të detyrueshëm, nëse nuk është i kënaqur me fondin pensional të detyrueshëm ku bën pjesë, gjegjësisht me shoqërinë që menaxhon me të. Nëse personi ka qenë anëtar në fondin pensional të detyrueshëm më shkurt se 24 muaj, gjatë kalimit, ai është i detyruar të paguajë komision për kalim. Nëse personi ka qenë anëtar në ndonjë fond më gjatë se 24 muaj, atëherë kalimi në një fond tjetër është pa pagesë. Gjatë kalimit, transferohen edhe të gjitha mjetet nga llogaria e anëtarit.


Në tabelën 5.1. janë dhënë të dhënat për numrin e anëtarëve që kanë kaluar nga njëri në fondin tjetër pensional të detyrueshëm dhe për vlerën e mjeteve të transferuara nga njëri në fondin tjetër pensional të detyrueshëm, mbi këtë bazë, gjatë vitit 2025.

Tabela 5.1. Kalimet e anëtarëve nga njëri në fondin tjetër pensional të detyrueshëm

2025		FPD-të në të cilat kanë kaluar anëtarët, gjegjësisht në të cilat janë transferuar mjetet			
		SAVAd	KBPd	TRIGLAVd	Gjithsej
Anëtarët që kanë kaluar nga FPD	SAVAz		1.072	2.951	4.023
	BKPz	972		3.330	4.302
	TRIGLLAVz	600	1.758		2.358
	Gjithse	1.572	2.830	6.281	10.683
Mjetet që janë transferuar nga FPD (në denarë)	SAVAz		420.554.906	948.079.031	1.368.633.937
	BKPz	404.442.258		1.045.562.102	1.450.004.360
	TRIGLAVz	271.377.799	685.158.447		956.536.246
	Gjithsej	675.820.057	1.105.713.353	1.993.641.133	3.775.174.543


Lëvizshmëria në trendin e kalimit të anëtarëve nga njëri në fondin tjetër pensional të detyrueshëm, e cila u nxit me fillimin e punës së fondit të tretë pensional të detyrueshëm në vitin 2019, ka vazhduar edhe në vitin 2025. Gjatë vitit 2025, numri i përgjithshëm i anëtarëve në fondet pensionale të detyrueshme, të cilët kanë kaluar nga njëri fond në tjetrin, arrin në 10.683, që përfaqëson 1,69% të numrit të përgjithshëm të anëtarëve. Pjesëmarrja në përqindje e anëtarëve që kanë bërë ndryshimin e fondit pensional të detyrueshëm në raport me numrin e përgjithshëm të anëtarëve në vitin 2025 është zvogëluar, dhe numri i anëtarëve që kanë ndryshuar fondin pensional të detyrueshëm është më i vogël në krahasim me vitin 2024. Në grafikun 5.7. është dhënë pasqyra e të gjitha kalimeve të anëtarëve nga njëri në fondin tjetër pensional të detyrueshëm dhe gjithsej mjetet e transferuara nga njëri fond në tjetrin nga viti 2008 deri në vitin 2025.

Grafiku 5.7. Pasqyra e kalimeve të anëtarëve dhe gjithsej mjetet e transferuara nga njëri në fondin tjetër pensional të detyrueshëm (2008-2025)



Në vitin 2025, pjesa më e madhe ose 59% e anëtarëve që zgjodhën të kalojnë në një fond tjetër pensional të detyrueshëm kaluan në TRIGLAVz, pastaj 26% kaluan në BKPz dhe 15% e anëtarëve që zgjodhën të kalojnë në një fond tjetër pensional të detyrueshëm kaluan në SAVAz. Sa u përket mjeteve, pjesa më e madhe ose 53% e mjeteve të anëtarëve që zgjodhën të kalojnë në një fond tjetër pensional të detyrueshëm u transferuan në TRIGLAVz, 29% u transferuan në BKPz dhe 18% e mjeteve u transferuan në SAVAz. Në grafikun 5.8. është paraqitur shpërndarja e kalimeve të anëtarëve nga njëri në fondin tjetër pensional të detyrueshëm dhe shpërndarja e mjeteve të transferuara nga njëri në fondin tjetër pensional të detyrueshëm në vitin 2025.


Grafiku 5.8. Shpërndarja e anëtarëve që kanë kaluar dhe e mjeteve që janë transferuar në fond tjetër pensional të detyrueshëm në vitin 2025



5.4. Kontributet në fondet pensionale të detyrueshme

Pagesën e kontributeve për sigurimin pensional dhe invalidor e bën obliguesi për pagesën e kontributit, gjegjësisht punëdhënësi, në emër të të punësuarit. Drejtoria për të Hyra Publike (DHP) bën arkëtimin e integruar të kontributeve nga sigurimi shoqëror i detyrueshëm (kontributin për sigurim pensional dhe invalidor, kontributin për sigurim shëndetësor dhe kontributin për punësim në rast papunësie) dhe tatimin mbi të hyrat personale.

Grafiku 5.9. Paraqitja skematike e pagesës dhe e shpërndarjes së kontributeve



Për të siguruarit që marrin pjesë në sistemin me një shtyllë, kontributi i paguar i plotë mbetet në Fondin e SPIMV-së (për vitin 2025, ai arrinte në 18,8% të pagës bruto). Për të siguruarit që janë të përfshirë në sistemin me dy shtylla, Fondi i SPIMV-së bën shpërndarjen e kontributit të paguar ndërmjet shtyllës së parë dhe të dytë. Lartësia e kontributit që transferohet në fondin pensional të detyrueshëm arrin në 6% të pagës bruto, ndërsa në Fondin e SPIMV-së mbetet kontributi në lartësi që fitohet si diferencë midis kontributit të përgjithshëm për sigurim pensional dhe invalidor dhe kontributit të paguar në fondin pensional të detyrueshëm (për vitin 2025, ai arrinte në 12,8% të pagës bruto (12,8% = 18,8% – 6%)).

Menjëherë, e më së voni në afat prej pesë ditësh pune nga pranimi i kontributeve, Fondi i SPIMV-së i transferon kontributet e anëtarëve të fondeve pensionale të detyrueshme në llogaritë individuale në fondet pensionale të detyrueshme të zgjedhura, me kusht që, brenda të njëjtit afat, të jenë pranuar edhe të dhënat përkatëse në përputhje me ligjin, të cilat i mundësojnë Fondit të SPIMV-së ta përmbushë këtë detyrim.

Nëse Fondi i SPIMV-së nuk i transferon kontributet e anëtarëve në llogaritë e fondeve pensionale të detyrueshme të zgjedhura menjëherë, e më së voni brenda pesë ditëve pune nga dita e pranimit të kontributeve për shkak të mungesës së të dhënave përkatëse, Fondi i SPIMV-së është i detyruar që në një afat jo më të gjatë se tre muaj nga dita e pranimit të kontributeve të sigurojë të dhënat përkatëse dhe të bëjë transferimin e kontributeve të anëtarëve në llogaritë e fondeve pensionale të detyrueshme të zgjedhura te kujdestari i pasurisë. Më pas, Fondi i SPIMV-së u dërgon të dhëna shoqërive dhe MAPAS-it në lidhje me transferimin e kryer të kontributeve.

Gjatë vitit 2025, në fondet pensionale të detyrueshme janë transferuar kontribute në vlerë prej rreth 17,48 miliardë denarë, gjë që përfaqëson rreth 1,67% të PBB-së së RMV-së. Gjithsej kontributet e paguara në fondet pensionale të detyrueshme vazhdojnë të rriten dhe në vitin 2025 janë rritur për 12,95% në raport me gjithsej kontributet e paguara në vitin 2024. Kontributet e paguara në mënyrë të detajuar sipas muajve (në milionë denarë) janë paraqitur në tabelën 5.2.


Tabela 5.2. Kontributet e paguara në shtyllën e dytë *(në milionë denarë)*

	Gjithsej 2024	Jan	Shkurt	Mars.	Prill.	Maj	Qersh.	Korrik.	Gusht.	Shtat.	Tetor.	Nëntor.	Dhjet.	Gjithsej 2025
САВАз	6.616	532	566	572	600	626	607	624	570	617	634	599	793	7.341
КБПз	7.189	590	618	624	650	684	662	680	623	686	678	654	867	8.018
ТРИГЛАВз	1.671	148	157	159	167	176	174	180	169	186	188	180	237	2.122
Вкупно	15.476	1.271	1.341	1.356	1.417	1.487	1.444	1.484	1.362	1.489	1.500	1.434	1.897	17.481

[11] *Burimi për PBB-në: ESHS – Komunikatë: Produkti i Brendshëm Bruto, tremujori i katërt i vitit 2025 – të dhëna të vlerësuara*

Në grafikun 5.10. është paraqitur rritja e gjithsej kontributeve (në miliardë denarë), të paguara në shtyllën e dytë sipas fondit, për çdo vit, që nga fillimi i punës së sigurimit pensional të detyrueshëm me financim kapital deri në vitin 2025, si dhe numri i përgjithshëm i anëtarëve sipas fondit, në fund të çdo viti, në të njëjtën periudhë. Kontributet e paguara në nivel vjetor rriten te të gjitha fondet pensionale, më së shumti për shkak të rritjes së numrit të anëtarëve, si dhe rritjes së pagave përgjatë viteve, pasi lartësia e kontributit që transferohet në fondet pensionale të detyrueshme nuk ndryshon dhe që nga viti 2012 arrin në 6% të pagës bruto.

Grafiku 5.10. Kontributet e paguara dhe anëtarët në shtyllën e dytë



5.4.1. Komisioni për transferim jo me kohë të kontributeve

Ndryshimet e Ligjit për sigurim pensional të detyrueshëm me financim kapital të datës 28.12.2018 parashikojnë detyrimin e Fondit të SPIMV-së për pagesën e një komisioni për transferim jo me kohë të kontributeve në rastet kur Fondi i SPIMV-së nuk i ka shpërndarë të siguruarit që kanë qenë anëtarë të detyrueshëm të shtyllës së dytë sipas kritereve para miratimit të ndryshimeve ligjore; në rast se Fondi i SPIMV-së nuk bën shpërndarjen e të siguruarve që janë anëtarë të detyrueshëm të shtyllës së dytë sipas kritereve të reja të anëtarësimit në afat prej tre muajsh pas përfshirjes së tyre në sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor; si dhe në rast se Fondi i SPIMV-së nuk i transferon kontributet e anëtarëve të fondeve pensionale të detyrueshme në llogaritë e fondeve pensionale të detyrueshme të zgjedhura në afat prej tre muajsh nga dita e pranimit të kontributeve. Mjetet për sigurimin pensional të detyrueshëm me financim kapital, të realizuara në bazë të pagesës jo me kohë dhe jo të plotë të kontributit, transferohen në llogarinë individuale të anëtarit të fondit pensional të detyrueshëm.

Vlera e komisionit për transferim jo me kohë të kontributeve përcaktohet në bazë të vlerësimit të gjendjes së një llogarie individuale hipotetike të anëtarit të fondit pensional të detyrueshëm, i cili ka histori identike të pagesave të kontributeve me të siguruarin me shpërndarje jo me kohë, gjegjësisht në bazë të vlerësimit të gjendjes së një pjese të mjeteve në llogarinë individuale të anëtarit të fondit pensional të detyrueshëm, vlerës së gjithsej kontributeve të transferuara jo me kohë dhe komisioneve nga kontributet që i arkëton shoqëria pensionale.

Në vitin 2025, Fondi i SPIMV-së transferoi në fondet pensionale të detyrueshme gjithsej rreth 0,87 milionë denarë si komision për transferim jo me kohë të kontributeve për anëtarët për të cilët nuk i kishte transferuar kontributet në llogaritë e fondeve pensionale të detyrueshme të zgjedhura në afat prej tre muajsh nga dita e pranimit të kontributeve. Në tabelën 5.3. janë paraqitur të dhëna të detajuara për komisionet e transferuara për transferim jo me kohë të kontributeve sipas fondeve.

[12] *Formula për llogaritjen e komisionit për transferim jo me kohë të kontributeve është e rregulluar në Rregulloren për transferim jo me kohë të kontributeve.*

Tabela 5.3. Komisionet e paguara për transferim jo me kohë të kontributeve për kontributet e transferuara jo me kohë në shtyllën e dytë në vitin 2025 (në milionë denarë)

Fondi pensional i detyrueshëm	Komisioni për transferim jo me kohë të kontributeve
SAVAz	0,37
BKPz	0,43
TRIGLAVz	0,07
Gjithsej	0,87

5.4.2. Mjetet e kthyera në Fondin e SPIMV-së

Gjatë vitit 2025, një pjesë e mjeteve të paguara në fondet pensionale të detyrueshme (rreth 684 milionë denarë) u kthye në Fondin e SPIMV-së për disa arsye:

- realizimi i së drejtës për pension invalidor ose familjar;
- tepricë e kontributeve të paguara në shtyllën e dytë për shkak të gabimeve teknike ose pagesave të tepërta nga ana e punëdhënësit;
- shkëputja e kontratave të anëtarësimit ose anulimi i shpërndarjes;
- ndërprerja e anëtarësimit të të siguruarve të cilët gjatë kohës së sigurimit kanë plotësuar stazh sigurimi me kohëzgjatje të rritur (stazh i beneficuar), gjë që mundëson zvogëlimin e kufirit të moshës për realizimin e së drejtës për pension pleqërie për të paktën një vit; dhe
- ndërprerja e anëtarësimit të të siguruarit i punësuar për herë të parë para 1.1.2003, i lindur para 1.1.1967, i cili nuk ka nënshkruar deklaratë për vazhdimin e anëtarësimit.

Në vitin 2025, pjesa më e madhe e mjeteve të kthyera në Fondin e SPIMV-së (71%) i referohet ndërprerjes së anëtarësimit të të siguruarve të cilët gjatë kohës së sigurimit kanë plotësuar stazh sigurimi me kohëzgjatje të rritur që mundëson zvogëlimin e kufirit të moshës për realizimin e së drejtës për pension pleqërie për të paktën një vit, dhe të cilët nuk kanë dorëzuar deklaratë me shkrim për vazhdimin e anëtarësimit në fondin pensional të detyrueshëm në afat prej tre muajsh nga plotësimi i atij stazhi sigurimi.

Struktura e mjeteve të kthyera në Fondin e SPIMV-së, sipas fondeve pensionale të detyrueshme, është paraqitur në mënyrë të detajuar në tabelën 5.4.

Tabela 5.4. Struktura e mjeteve të kthyera në Fondin e SPIMV-së, sipas FPD-ve *(në milionë denarë)*

Arsyet	Nga fondi pensional i detyrueshëm			Gjithsej
	SAVAz	BKPz	TRIGLAVz	
Pension i realizuar	73,73	68,36	7,00	149,09
- pension invalidor	20,48	17,84	1,11	39,43
- pension familjar	53,26	50,52	5,89	109,66
Tepricë e pagesave të kontributit	9,22	9,25	2,435	20,90
Shkëputje e kontratave dhe anulim i shpërndarjeve	2,55	7,25	0,28	10,08
Ndërprerje e anëtarësimit	204,51	216,01	29,35	449,88
- anëtarë të cilët gjatë kohës së sigurimit kanë plotësuar stazh sigurimi me kohëzgjatje të rritur (stazh i beneficuar), gjë që mundëson zvogëlimin e kufirit të moshës për realizimin e së drejtës për pension pleqërie për të paktën një vit	204,02	216,01	29,35	449,39
- anëtarë të punësuar për herë të parë para 1.1.2003, të lindur para 1.1.1967, të cilët nuk kanë nënshkruar deklaratë	0,49	0,00	0,00	0,49
Gjithsej	290,02	300,87	39,07	629,96

5.5. Investimi dhe struktura e portfolios së fondeve pensionale të detyrueshme

Zakonisht, në sistemet pensionale të financuara me kapitale të detyrueshme, në fazën fillestare përdoren kontrolli proaktiv dhe kufizimet kuantitative e kualitative të investimeve. Duke u nisur nga kjo, në ligj dhe në aktet nënligjore janë definuar qëllimet dhe parimet e investimit, llojet e instrumenteve ku mund të investohen mjetet e fondeve pensionale të detyrueshme, kushtet që duhet t'i plotësojnë tregjet e rregulluara dytësore të kapitalit ku tregtohen mjetet e fondeve pensionale të detyrueshme, cilësia e instrumenteve ku mund të investohen mjetet e fondeve pensionale të detyrueshme, shtetet ose grupet e shteteve ku mund të investohen mjetet e fondeve pensionale të detyrueshme, kufizimet e investimeve brenda instrumenteve dhe emetuesve, investimet e ndaluara, tejkalimi i kufizimeve të investimeve, etj.

Shoqëria është e detyruar t'i investojë mjetet e fondit pensional të detyrueshëm në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore, si dhe me strategjinë e saj të investimit, me qëllim të realizimit të kthimit më të lartë, ekskluzivisht në dobi të anëtarëve dhe të anëtarëve të pensionuar të fondit pensional të detyrueshëm. Përmes diversifikimit dhe analizës fi-

nanciare, ajo duhet të minimizojë rrezikun nga humbjet që vijnë si pasojë e mospagimit nga emetuesi ose pala tjetër kontraktuese, humbjet që rrjedhin nga ndikimi i tregjeve financiare vendase dhe të huaja, humbjet në vlerën reale të mjeteve të fondit pensional të detyrueshëm për shkak të inflacionit, si dhe humbjet që janë pasojë e shitjes së mjeteve të fondit pensional të detyrueshëm për të siguruar likuiditetin e fondit pensional të detyrueshëm.

Gjatë këtij procesi, anëtari i bordit drejtues dhe i bordit mbikëqyrës në shoqëri, gjatë menaxhimit dhe kontrollit të investimit të mjeteve të fondit pensional të detyrueshëm, është i detyruar të aplikojë një shkallë kujdesi, efikasiteti dhe shkathtësie që një person i arsyeshëm do t'i aplikonte gjatë investimit të mjeteve të veta. Çdo anëtar i bordit drejtues dhe i bordit mbikëqyrës në shoqëri duhet ta përmbushë detyrimin e tij në përputhje me detyrat e tij fiduciare dhe duhet të sigurojë zbatimin e tyre nga çdo i punësuar dhe person i angazhuar në punë në shoqëri.

Në ligj dhe në aktet nënligjore është e rregulluar që mjetet e fondeve pensionale të detyrueshme mund të investohen në depozita bankare dhe në certifikata të depozitave, në bono dhe në letra të tjera me vlerë të borxhit, në aksione dhe në dëftesa komerciale, të emetuara nga emetues me seli në RMV dhe jashtë vendit, në shtetet anëtare të BE-së ose të OECD-së. Duke pasur parasysh se është e domosdoshme të arrihet një diversifikim i duhur ndërmjet llojeve të ndryshme të investimeve, janë parashikuar kufizime maksimale për investim në një kompani të caktuar dhe kufizime maksimale të vlerave që mund të investohen në lloje të caktuara të instrumenteve.

Me qëllim të parandalimit të investimeve në instrumente që nuk janë të përshtatshme për investimin e fondeve pensionale të detyrueshme, ligjërisht ndalohen investimet në aksione, bono dhe letra të tjera me vlerë që nuk kuotohen në tregun zyrtar ose me të cilat nuk tregtohet publikisht, instrumente me të cilat nuk mund të disponohet juridikisht, instrumente që nuk mund të vlerësohen menjëherë, shumica e formave të pronës që nuk mund të vlerësohen menjëherë, si dhe artikuj me vlerë të pasigurt (për shembull: antikuitete, vepra arti, etj.).

Meqenëse mjetet e fondeve pensionale të detyrueshme janë në rritje të vazhdueshme, rritja e tyre shoqërohet me mundësinë e daljes në një numër më të madh të tregjeve të kapitalit dhe në vëllim më të madh, pasi tregu vendas po bëhet i vogël në raport me nevojat për investimin e mjeteve të fondeve pensionale të detyrueshme. Kjo bëhet edhe me qëllim që të mundësohet një diversifikim më i madh i mjeteve gjatë investimit të tyre dhe një përzgjedhje më e madhe e kompanive për investimin e mjeteve të fondeve pensionale të detyrueshme nga ana e shoqërive. Kufizimet maksimale të investimeve janë paraqitur në tabelën 5.5.


Tabela 5.5. Kufizimet maksimale të investimeve

Investimet jashtë vendit (BE dhe OECD)	50%
- bono dhe letrat e tjera me vlerë të emetuara nga qeveritë e huaja dhe bankat qendrore	50%
- letrat me vlerë të emetuara nga kompanitë e huaja joshtetërore, bankat ose fondet e investimeve	30%
Letrat me vlerë të emetuara ose të garantuara nga RMV në tregun vendas ose nga BPRMV	80%
Depozitat bankare, certifikatat e depozitave, bonot, letrat me vlerë të bazuara në hipotekë dhe letrat e tjera me vlerë të emetuara nga bankat vendase	60%
depozitat bankare	30%
Bonot e emetuara nga njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe nga shoqëritë aksionare vendase që nuk janë banka, si dhe dëftesat komerciale nga shoqëritë aksionare vendase që nuk janë banka	40%
-bonot e emetuara nga njësitë e vetëqeverisjes lokale	10%
Aksionet e emetuara nga shoqëritë aksionare vendase	30%
Dokumentet e pjesëmarrjes (kuotat) dhe aksionet në fondet e investimeve të hapura, të mbyllura dhe private në RMV	5%
-dokumentet e pjesëmarrjes (kuotat) në fondet private të investimeve	1,5%


MAPAS-i mund të përshkruajë kufizime të investimeve në lloje të caktuara të instrumenteve ndryshe nga kufizimet e përcaktuara me ligj, të cilat do të vlejnë brenda një afati gjithashtu të përcaktuar nga MAPAS-i, por jo më shumë se pesë vjet. Në vitin 2019 u miratuan vendime për kufizime shtesë, sipas të cilave përqindja maksimale e vlerës së mjeteve të fondit pensional të detyrueshëm dhe vullnetar që mund të investohen në depozita në bankat që kanë leje të lëshuar nga BPRMV-ja (nëse mbartin interes), gjegjësisht në bono dhe letra të tjera me vlerë që i emeton ose për të cilat garanton RMV-ja në tregun vendas, në një periudhë prej një viti nga data e pagesës së parë në fondin pensional të detyrueshëm dhe vullnetar, arrin në 100%.

Struktura e investimeve të fondeve pensionale të detyrueshme SAVAz dhe BKPz, që nga fillimi i funksionimit të sistemit (për periudhën 2006 – 2024 në nivel vjetor, ndërsa për vitin 2025 në nivel tremujor) është paraqitur në grafikun 5.11. backyard në grafikun 5.12. Struktura e investimeve të fondit pensional të detyrueshëm TRIGLAVz që nga fillimi i punës së fondit (01.04.2019) dhe në nivel tremujor për vitin 2025 është paraqitur në grafikun 5.13.


Grafiku 5.11. Struktura e investimeve të SAVAz



Grafiku 5.12. Struktura e investimeve të BKPz




Grafiku 5.13. Struktura e investimeve të TRIGLAVz




Struktura e investimeve të gjithsej mjeteve të fondeve pensionale të detyrueshme, me gjendje më 31.12.2025, nuk dallon shumë në krahasim co strukturën e investimeve të fondeve pensionale të detyrueshme me gjendje më 31.12.2024 dhe ajo është paraqitur në grafikun 5.14. Pjesëmarrja e bondeve vendase, të cilat përfshijnë vetëm bonot shtetërore, arrin në 63,74%, që paraqet një rënie prej një pike përqindjeje në krahasim me gjendjen më 31.12.2024 (64,93%). Gjithashtu, edhe pjesëmarrja e depozitave bankare (1,08%) dhe pjesëmarrja e aksioneve vendase (1,45%) kanë shënuar një rënie të lehtë në krahasim me gjendjen e vitit të kaluar. Një pjesë shumë e vogël e investimeve të fondeve pensionale të detyrueshme u përket investimeve në kuota të fondeve vendase të investimit (0,51%). Në llogari të rënies së pjesëmarrjes së investimeve në instrumente të emetuara nga emetues vendas, në vitin 2025 pjesëmarrja e investimeve jashtë vendit u rrit për një pikë përqindjeje në raport me vitin paraprak dhe arrin në 30,98%. Në vitin 2025, njëri fond pensional investoi edhe në dëftesa shtetërore të huaja (bono thesari), prandaj investimet në letra me vlerë të huaja përfshijnë investime në bono shtetërore të huaja (2,02%), dëftesa shtetërore të huaja (0,14%), kuota në fonde investimi (25,46%) dhe investime në aksione (3,36%). Mjetet e mbetura përbëhen nga paratë e gatshme me 0,45% dhe kërkesat (harkesat) me 1,79%.

Grafiku 5.14. Struktura e investimeve të gjithsej mjeteve të fondeve pensionale të detyrueshme më 31.12.2025



Gjatë vitit 2025, të tre fondet pensionale të detyrueshme investuan brenda kufijve maksimalë ligjorë të investimeve. Në grafikun 5.15. është paraqitur pjesëmarrja në përqindje në portofol sipas klasave të mjeteve te SAVAz, BKPz dhe TRIGLAVz, si dhe kufizimet ligjore, me gjendje më 31.12.2025.

Grafikoni 5.15. Klasat e mjeteve në portofolin e FPD-ve të krahasuara me kufizimet ligjore




Si edhe në vitin e kaluar, ashtu edhe në vitin 2025, një përqindje e vogël e mjeteve të fondeve të detyrueshme pensionale (1,45%) janë investuar në aksione të emetuesve vendas. Në vitin 2025 te SAVAz dhe te KBPz ekspozimi në aksione u zvogëlua pak në krahasim me vitin 2024. Me këtë rast, ekspozimi ndaj aksioneve në emetues vendas është më i madh te SAVAz (2,12%) në raport me KBPz (1,11%). TRIGLAVz, duke filluar nga 31.12.2025, nuk ka investime në aksione të emetuesve vendas.

Krahasimisht, lëvizja e vlerës së Indeksit të Bursës së Maqedonisë - MBI10, Indeksit të obligacioneve të Bursës së Maqedonisë-OMB dhe vlerave të njësive të kontabilitetit të fondeve të detyrueshme pensionale, gjatë vitit 2025, janë paraqitur në grafikun 5.16. Vlera e njësisë së kontabilitetit të SAVAz shënoi rritje prej 5,14%, njësisë së kontabilitetit të KBPz rritje prej 5,21% dhe njësisë së kontabilitetit të TRIGLAVz rritje prej 5,14%. MBI10, gjatë vitit 2025, shënoi zvogëlim prej 1,43% ndërsa OMB, gjatë vitit 2024, shënoi rritje prej 4,30%14.


[13] *Lëvizjet janë paraqitur përmes ndryshimit të indekseve/njësive në raport me indeksin fillestar të barabartë me 100, më 31.12.2024.*
[14] *Burimi: Bursa e Maqedonisë SHA Shkup – Buletini vjetor statistikor 2025.*

Grafiku 5.16. Lëvizja krahasuese e vlerës së MBI10, OMB dhe vlerës së njësisë së kontabilitetit të FDP, viti 2025



Në vitin 2025, më shumë se 60% e mjeteve të fondeve të detyrueshme pensionale u përkasin letrave me vlerë shtetërore, përkatësisht letrave me vlerë shtetërore vendase (64,17% te SAVAz, 63,31% te KBPz dhe 63,99% te TRIGLAVz) dhe letrave me vlerë shtetërore të huaja (1,99% te SAVAz dhe 2,71% te KBPz). Duke i parë sipas sektorëve, më shumë se një e pesta e mjeteve të tre fondeve pensionale janë investime në instrumente nga emetues/shoqëri aksionare nga sektori financiar, përkatësisht 22,23% te SAVAz, 30,93% te KBPz dhe 33,13% te TRIGLAVz. Brenda këtij sektori: Te SAVAz, pjesëmarrja më e madhe është e pjesëve në fonde investimi të huaja dhe vendase (90,26%) dhe depozitave bankare vendase (6,11%), ndërsa pjesëmarrje më e vogël është e shërbimeve financiare (2,84%) dhe aksioneve në banka vendase (0,80%). Te KBPz, brenda sektorit financiar mbizotëron pjesëmarrja e fondeve të huaja dhe vendase të investimit (97,32%), e pasuar nga depozitat bankare vendase (2,68%). Te TRIGLAVz, brenda sektorit financiar mbizotëron pjesëmarrja e fondeve të huaja dhe vendase të investimit (96,75%), e pasuar nga depozitat bankare vendase (3,25%). Përveç sektorëve të lartpërmendur, fondet e detyrueshme pensionale investojnë edhe në sektorë të tjerë: farmaci, mallra konsumi, industri, mallra bazë, teknologji informatike, shërbime komunikimi dhe energji, por me një pjesëmarrje shumë më të vogël (nga 0,44% deri në 1,78%). Struktura e investimeve të fondeve të detyrueshme pensionale sipas sektorëve është paraqitur në grafikun 5.17.

Grafiku 5.17. Struktura e investimeve të FDP sipas sektorëve



Sipas strukturës valutore të mjeteve të fondeve të detyrueshme pensionale, e cila është paraqitur në grafikun 5.18, mund të vërehet se në vitin 2025 te të tre fondet e detyrueshme pensionale pjesa më e madhe e mjeteve janë investuar në valutë vendase (46,37% te SAVAz, 46,47% te KBPz dhe 68,25% te TRIGLAVz), me çka vërehet edhe rritje e pjesëmarrjes në raport me vitin 2024 te të gjitha fondet. Me këtë, pjesëmarrja e mjeteve të investuara në instrumente në valuta të huaja u zvogëlua.

Te SAVAz u zvogëlua më dukshëm pjesëmarrja në instrumente në euro (27,74%), ndërsa pjesëmarrja në instrumente në dollarë amerikanë (25,49%) u rrit pak.


Një pjesë shumë e vogël e mjeteve të SAVAz janë investuar në franga zvicerane (0,40%).

Te KBPz, pjesëmarrja në instrumente në euro (25,41%) është më e vogël se pjesëmarrja në instrumente në dollarë amerikanë (28,13%).

Struktura valutore e TRIGLAVz dallon në raport me strukturën valutore të SAVAz dhe KBPz në lidhje me pjesëmarrjen në instrumente në euro dhe në denarë.


Pesha e mjeteve të TRIGLAVz është ende në anën e mjeteve të cilat janë investuar në instrumente në denarë (68,25%), pastaj 28,21% e mjeteve janë investuar në instrumente në dollarë amerikanë, ndërsa pjesa më e vogël e mjeteve janë investuar në instrumente në euro (3,53%).

Grafiku 5.18. Struktura valutore e mjeteve të FDP, 2024-2025



Nëse bëhet një krahasim me vendet e rajonit të cilat kanë sisteme pensionale të ngjashme me atë maqedonas, mund të shihen ngjashmëri, por edhe dallime të konsiderueshme në portofolet investuese të fondeve të detyrueshme pensionale. Në grafikun 5.19 janë paraqitur portofolet e fondeve pensionale (të cilat korrespondojnë me fondet e detyrueshme pensionale në Maqedoninë e Veriut) në disa vende dhe në RMV, më 31.12.2025.

Grafiku 5.19. Portofolet e fondeve pensionale në disa vende dhe në RMV



Nëse portofolet e fondeve të detyrueshme pensionale shqyrtohen sipas llojeve të instrumenteve, mund të vërehet se, në të gjitha vendet, mbi 50% e mjeteve të fondeve pensionale janë investuar në obligacione dhe letra të tjera me vlerë, për të cilat garanton shteti, ose pushteti lokal (66% në Maqedoninë e Veriut, 65% në Rumani, 55% në Bullgari dhe 53% në Kroaci B.

Pjesa e mbetur e mjeteve janë investuar në mënyra të ndryshme. Në aksione dhe pjesë më së shumti investohet në Kroaci B (36%), pastaj Maqedonia e Veriut dhe Bullgaria (31%) dhe Rumania (30%). Më së shumti investime në depozita kanë fondet pensionale në Kroaci B (6%), pastaj vijojnë Maqedonia dhe Rumania (1%) dhe Bullgaria (më pak se 1%). Fondet pensionale kanë investuar edhe në obligacione korporative, përkatësisht 7% në Bullgari, 4% në Rumani dhe 1% në Kroaci B.

Në vitin 2025, investime në patundshmëri përveç fondeve pensionale në Bullgari (1%) kanë edhe fondet pensionale në Kroaci B (1%) (në vendet e tjera, ky instrument, më së shpeshti, nuk është i lejuar). Në lidhje me ekspozimin e portofoleve të fondeve të detyrueshme pensionale në instrumente të lëshuara nga lëshues nga jashtë, mund të vërehet se fondet pensionale në Kroaci B (39%) kanë ekspozim më të madh në instrumente nga lëshues nga jashtë në raport me fondet pensionale nga Maqedonia e Veriut (31%).

[15] *Burimet: www.hanfa.hr; www.fsc.bg; www.asfromania.ro dhe përllogaritjet vetjake*

5.6 Mjetet neto, njësia kontabël dhe shkalla e kthimit të fondeve të detyrueshme pensionale

Kontributet e paguara në fondet e detyrueshme pensionale, të zvogëluara për kompensimin nga kontributet, investohen menjëherë. Kthimi i përgjithshëm i realizuar i atribuohet mjeteve në fondin e detyrueshëm pensional, përkatësisht llogarive individuale të anëtarëve. Një herë në muaj shoqëritë arkëtojnë edhe kompensim për menaxhimin me mjetet, që llogaritet në baza ditore, si përqindje e mjeteve neto të fondit të detyrueshëm pensional. Për më tepër, gjatë çdo transaksioni, me mjetet e fondit të detyrueshëm pensional arkëtohen provizionet e transaksionit nga vetë fondi i detyrueshëm pensional. Çdo ditë bëhet vlerësimi i vlerës së mjeteve të fondit të detyrueshëm pensional. Ajo përcaktohet në bazë të vlerës së tregut të secilit mjet individual ose në bazë të vlerës së amortizuar të mjetit, nëse instrumenti mbahet deri në maturim, ose në portofolin e disponueshëm për shitje, ose nëse nuk mund të vlerësohet vlera e tij e tregut.

Ndryshimet e mjeteve të fondeve të detyrueshme pensionale nga fillimi deri në fund të vitit ndodhin për shkak të:

- prurjes së kontributeve,
- prurjes së kompensimeve për transferim jo në kohë të kontributeve në rast të transferimit jo në kohë të kontributeve,
- derdhjes për shkak të kompensimeve dhe provizioneve të transaksionit,
- prurjes për shkak të kalimit nga fondi tjetër i detyrueshëm pensional (për persona që paraprakisht kanë qenë të shpërndarë përkohësisht në fond tjetër, e pastaj kanë nënshkruar marrëveshje me fondin aktual dhe për persona që kanë qenë anëtarë në fond tjetër, e pastaj kanë kaluar në fondin aktual),
- derdhjes për shkak të kalimit në fondin tjetër të detyrueshëm pensional (për persona që kanë qenë të shpërndarë përkohësisht në fondin përkatës, por pastaj kanë nënshkruar marrëveshje me fondin tjetër dhe persona që kanë qenë anëtarë në fondin përkatës, e pastaj kanë kaluar në fondin tjetër),
- derdhjes për persona që i kanë shkëputur marrëveshjet për anëtarësim, derdhjes për shkak të tepricës së kontributit të paguar, derdhjes për shkak të realizimit të së drejtës për pension invalidor ose familjar dhe derdhjes për persona të të cilëve u ka pushuar anëtarësimi në fondin e detyrueshëm pensional, të cilët gjatë sigurimit kanë arritur stazh sigurimi me kohëzgjatje të rritur që mundëson zvogëlimin e kufirit të moshës për realizimin e së drejtës për pension pleqërie për të paktën një vit,
- derdhjes për shkak të pagesës së trashëgimisë,
- derdhjes për shkak të pagesave njëshe për persona që nuk kanë realizuar të drejtë për

[16] *Në Kroaci ekzistojnë multifonde, përkatësisht tri kategori të fondeve pensionale: A (me rrezik më të lartë), B (portofolet ekzistuese në momentin e vendosjes së multifondeve) dhe C (me rrezik më të ulët).*

[17] *Të dhënat për investime jashtë vendit për Bullgarinë me gjendje 31.12.2025 nuk ishin të disponueshme në të dhënat e marra.*

pension pleqërie.
- derdhjes për shkak të pagesës së pensionit të pleqërisë – tërheqje të programuara,
- derdhjes për shkak të pagesës së pensionit familjar – tërheqje të programuara,
- fitime ose humbje të (pa)realizuara nga investimet.

Duke u nisur nga vlera e mjeteve neto, në fund të vitit të kaluar, dhe duke pasur parasysh të gjitha ndryshimet e lartpërmendura, arrihet deri te vlera e mjeteve neto, në fund të vitit, e cila është paraqitur në tabelën 5.6.

Tabela 5.6. Ndryshimet e mjeteve të FDP *(në milionë denarë)*


	SAVAz	BKPz	TRIGLAVz	Gjithsejz
Mjetet neto në 31.12.2024	70.682,46	79.340,24	12.831,23	162.853,93
Kontributet	7.341,13	8.018,44	2.121,60	17.481,17
Tarifat nga kontributet	124,83	136,35	36,08	297,26
Kontributet e zvogëluara për kompensimet nga kontributet	7.216,30	7.882,09	2.085,52	17.183,91
Kompensimi për transferim jo në kohë të kontributeve	0,37	0,43	0,07	0,87
Kompensimet nga mjetet	270,09	303,72	52,54	626,35
Shpenzimet për provizionet ndërmjetësuese	1,95	1,31	0,18	3,45
Transferimi nga fondi tjetër	679,22	1.107,76	1.994,09	3.781,07
Transferimi në fondin tjetër	1.370,59	1.453,29	957,20	3.781,07
Transferimi në Fondin e PIVS në bazë të shkëputjes së kontratës, kthimit të kontributit, pensionimit dhe ndërprerjes së anëtarësimit	290,02	300,87	39,07	629,96
Pagesa e trashëgimisë	19,92	21,52	2,48	43,92
Pagesa e pensionit të pleqërisë – tërheqje të programuara	4,00	6,11	0,05	10,16
Pagesa njëshe	0,13	0,05	0,00	0,18
Pagesa e pensionit familjar – tërheqje të programuara	0,88	0,00	0,00	0,88
Fitimi bruto nga investimet	4.118,29	4.684,86	817,56	9.620,70
Fitimi neto nga investimet	3.846,24	4.379,83	764,84	8.990,91
Mjetet neto më 31.12.2025	80.739,06	90.928,51	16.676,95	188.344,53

Mjetet totale neto të fondeve të detyrueshme pensionale, me gjendje më 31.12.2025, arritën në 188,34 miliardë denarë ose rreth 3,06 miliardë euro, që përfaqëson 18,04% të PBB-së së RMV-së.

Në grafikun 5.20 janë paraqitur vlerat e mjeteve neto të fondeve të detyrueshme pensionale, në fund të çdo viti (2008-2025), dhe rritja e tyre në përqindje, në raport me mjetet neto në vitin paraprak. Mund të vërehet se mjetet neto edhe të SAVAz edhe të KBPz rriten me trend të ngjashëm. Rritja më e madhe edhe te SAVAz edhe te KBPz vërehet në vitin 2009 në raport me vitin 2008, ndërsa rritja më e vogël vërehet në vitin 2022 në raport me vitin 2021. Rritja vjetore e

mjeteve të SAVAz dhe KBPz pas vitit 2023 tashmë e ndjek trendin e pritur. Në vitin 2025 vërehet një rritje pak e zvogëluar në raport me rritjen në vitin 2024. Te TRIGLAVz vërehet një rritje e madhe e mjeteve neto në vitet fillestare të punës së fondit.


Grafiku 5.20. Rritja e mjeteve neto të FDP në përqindje në raport me vitin paraprak




Lëvizja e vlerës së mjeteve neto dhe e kontributeve kumulative, si dhe rritja e kontributeve të paguara dhe rritja e mjeteve neto të SAVAz dhe KBPz, nga fillimi i punës së sistemit (d.m.th. nga data e pagesës së parë, më 1.1.2006) deri më 31.12.2025, janë paraqitur në grafikun 5.21 dhe në grafikun 5.22.

Rritja e mjeteve neto të fondeve të detyrueshme pensionale është e implikuar nga rritja e kontributeve të paguara dhe nga rezultatet e investimeve. Pas zvogëlimit të rritjes në vitin 2022, në vitin 2023 vërehet sërish rritje e rritjes së mjeteve neto. Për vitin 2025, rreth 71% e rritjes së mjeteve neto i detyrohet kontributeve të paguara. Në krahasim me vitet e para të punës së fondeve, pjesëmarrja e kontributeve të paguara në rritjen totale të mjeteve neto shënon zvogëlim gradual, përveç në vitin 2022. Gjithashtu, mund të vërehet se, gjatë viteve të para, pjesëmarrja e kontributeve kumulative në mjetet totale neto është dukshëm e madhe, pastaj zvogëlohet gradualisht, dhe në tri vitet e fundit, mesatarisht arrin në 65%.


Grafiku 5.21. Rritja e mjeteve neto në krahasim me rritjen e kontributeve të paguara në SAVAz



Grafiku 5.22. Rritja e mjeteve neto në krahasim me rritjen e kontributeve të paguara te KBPz



Grafiku 5.23. Rritja e mjeteve neto në krahasim me rritjen e kontributeve të paguara te TRIGLAVz



Te SAVAz dhe KBPz, mjetet neto dhe kontributet kumulative rriten vazhdimisht që nga fillimi i funksionimit të sistemit. Rritja më e madhe e mjeteve neto (rreth 150%) si dhe e kontributeve të paguara (rreth 40%) edhe te SAVAz edhe te KBPz është vërejtur në vitin 2007. Kjo i detyrohet, me gjasë, rritjes më të madhe përqindëse të anëtarësisë, përkatësisht të kontributeve në raport me vitin paraprak, si dhe rritjes mjaft të lartë të njësisë. Pastaj pason rënia e rritjes edhe të mjeteve neto edhe të kontributeve të paguara. Me kalimin e viteve ka stabilizim gradual, kështu që rritja e mjeteve neto, në pesë vitet e fundit, mesatarisht arrin rreth 15%, ndërsa rritja e kontributeve të paguara, mesatarisht arrin 11%. Në vitin 2025 në raport me vitin 2024, vërehet zvogëlim i rritjes së kontributeve të paguara (11% te SAVAz dhe 12% te KBPz) dhe zvogëlim i rritjes së mjeteve neto (14% edhe te SAVAz edhe 15% te KBPz).

Lëvizja e vlerës së mjeteve neto dhe e kontributeve kumulative, si dhe rritja e kontributeve të paguara dhe rritja e mjeteve neto të TRIGLAVz, për periudhën prej shtatë viteve të punës së TRIGLAVz (2019 - 2025), është paraqitur në grafikun 5.23. Edhe pse e zvogëluar, edhe te TRIGLAVz vërehet rritje e mjeteve neto dhe kontributeve kumulative në vitin 2025 në raport me vitin 2024. Rritja e mjeteve neto të TRIGLAVz, përveç faktit që është e implikuar nga rritja e kontributeve të paguara, në masë të madhe i detyrohet edhe mjeteve të transferuara në TRIGLAVz nga SAVAz dhe KBPz mbi bazën e marrëveshjeve të lidhura për kalimin e anëtarëve të cilët kaluan nga SAVAz dhe KBPz në TRIGLAVz.

Për evidencën e mjeteve të fondeve të detyrueshme pensionale përdoren njësi kontabël. Një njësi kontabël përfaqëson pjesë proporcionale të mjeteve totale neto të fondit të detyrueshëm pensional. Vlera e njësisë kontabël është e barabartë me vlerën e mjeteve neto të pjesëtuar me numrin total të njësive kontabël në të gjitha llogaritë individuale dhe

nënllogaritë. Vlera fillestare e njësisë kontabël të një fondi pensional arrin 100 denarë. Fondet pensionale, duke përfshirë edhe ato maqedonase, i nënshtrohen dukurive dhe lëvizjeve ciklike, që nënkupton rritje ose rënie të vlerave të njësive të tyre kontabël, në varësi të investimit të mjeteve dhe të lëvizjes së vlerës së instrumenteve në të cilat janë investuar mjetet e fondeve pensionale, si dhe nga arkëtimi i kompensimeve dhe provizioneve.


Lëvizja e vlerës së njësive kontabël të fondeve të detyrueshme pensionale, nga fillimi i funksionimit të sistemit deri më 31.12.2025, është dhënë në tabelën 5.7, në grafikun 5.24 dhe në grafikun 5.25. Me këtë, që nga fillimi i punës së SAVAz dhe KBPz vërehet trend rritës i njësive kontabël. Më 1.4.2019 filloi me punë fondi i tretë i detyrueshëm pensional, TRIGLAVz. Në vitin 2025, edhe pse i ngadalësuar, vazhdoi trendi i rritjes së vlerave të njësive kontabël të tre fondeve të detyrueshme pensionale (5,14% te SAVAz dhe TRIGLAVz dhe 5,21% te KBPz). Rritja e ngadalësuar i detyrohet zvogëlimit të shumës së njësisë kontabël në fund të tremujorit të parë dhe fillimin e tremujorit të dytë (për shkak të lëvizjeve të tregjeve financiare të huaja) pas së cilës pason rritja graduale e njësisë. Fondet pensionale sipas natyrës së tyre punojnë afatgjatë, prandaj performancat e tyre duhet të vlerësohen afatgjatë.

Tabela 5.7. Vlera e njësisë kontabël nga fillimi i sistemit


Data	Vlera për njësi kontable (në denarë)		
	SAVAz	BKPz	TRIGLAVz
31.12.2006	105,929336	106,265900	
31.12.2007	115,511364	115,303221	
31.12.2008	100,155213	107,116421	
*31.12.2009	116,874672	120,667142	
31.12.2010	125,009646	129,590887	
31.12.2011	129,003093	130,697013	
31.12.2012	139,225567	142,372582	
31.12.2013	151,117506	153,757419	
31.12.2014	160,733889	164,578077	
31.12.2015	170,193521	174,392410	
31.12.2016	179,771032	184,786292	
31.12.2017	189,686331	195,037486	
31.12.2018	193,113009	196,706281	
31.12.2019	213,757775	218,317207	101,578448
31.12.2020	220,489334	227,667060	101,665261
31.12.2021	241,504146	252,373824	110,128711
31.12.2022	235,843874	246,231776	108,891957
31.12.2023	254,969666	264,141459	116,463817
31.12.2024	278,518719	288,532506	128,039370
31.03.2025	276,749434	286,476862	276,749434
30.06.2025	280,483275	291,539875	280,483275
30.09.2025	288,400197	299,472638	288,400197
31.12.2025	292,831861	303,569101	292,831861

**Në gjysmën e dytë të vitit 2009, të dyja shoqëritë, SAVA dhe KB Prvo, morën vendime për riklasifikimin e instrumenteve financiare që mbahen deri në maturim në kategorinë e instrumenteve financiare të disponueshme për shitje dhe, në këtë procedurë, shoqëritë kryen rivlerësimin e vlerës së instrumenteve financiare, me zbatimin e vlerës objektive, të drejtë dhe përcaktuan vlerën e mjeteve, të mjeteve neto, vlerën e njësive kontabël dhe numrin e njësive kontabël, gjë që shkaktoi një korrigjim relativisht të lartë të vlerës së njësive kontabël.*

Grafiku 5.24. Vlera e njësisë kontabël të FDP nga fillimi i sistemit



Grafiku 5.25. Vlera e njësisë kontabël të FDP në vitin 2025



[18]*TRIGLAVz përfshihet në analizat krahasuese për kthim me kthim të llogaritur për periudhat përkatëse, në pajtim me rregulloren, sepse ekziston më gjatë se 12 muaj, por më shkurt se 84 muaj.*

Zakonisht, kthimi për fondet pensionale llogaritet për disa vitet e fundit, i zbritur në nivel vjetor. Kështu, edhe në sistemin pensional maqedonas, është e rregulluar me ligj që kthimi të llogaritet për një periudhë prej shtatë vitesh (periudhë llogaritëse), i zbritur në nivel vjetor, në shumë nominale dhe reale. Nëse fondi ekziston më shkurt se 84 muaj, por më gjatë se 12 muaj, kthimi llogaritet në fund të qershorit, përkatësisht dhjetorit, për periudhën nga qershori i parë, përkatësisht dhjetori, pas themelimit të fondit, deri në fund të qershorit, përkatësisht dhjetorit, kur bëhet llogaritja. Në atë rast, periudha llogaritëse arrin në 78, 72, 66, 60, 54, 48, 42, 36, 30, 24, 18 ose 12 muaj.

Struktura e investimeve të mjeteve të përgjithshme të fondeve vullnetare pensionale, me gjendje më 31.12.2025, nuk ndryshon shumë në krahasim me strukturën e investimeve të fondeve vullnetare pensionale, me gjendje më 31.12.2024, dhe e njëjta është paraqitur në grafikun 6.13. Pjesëmarrja e obligacioneve vendase, të cilat përfshijnë vetëm obligacione shtetërore, arrin në 58,84%, që do të thotë se është rritur për tre pikë përqindjeje krahasuar me 31.12.2024. Në vitin 2025, një pjesë e vogël (0,08%) e mjeteve të fondeve vullnetare pensionale është investuar edhe në letra shtetërore afatshkurtra me vlerë. Pjesëmarrja e depozitave në bankat vendase u zvogëlua edhe në vitin 2025, dhe atë për pothuajse dy pikë përqindjeje krahasuar me vitin 2024, dhe arrin në 3,21%. Gjithashtu, pjesëmarrja e aksioneve të emetuesve vendas po zvogëlohet krahasuar me vitin paraprak për dy pikë përqindjeje dhe arrin në 4,04%. Një pjesë shumë e vogël e investimeve të fondeve vullnetare pensionale u përket investimeve në pjesë të fondeve investuese vendase (1,36%).

Në vitin 2025, pjesëmarrja e investimeve jashtë vendit mbetet pothuajse në të njëjtin nivel, krahasuar me vitin paraprak, dhe arrin në 31,44%. Në vitin 2025, tre fonde pensionale investuan edhe në obligacione shtetërore të huaja, ndërsa një fond pensional investoi edhe në letra shtetërore të huaja afatshkurtra me vlerë, kështu që investimet në letra të huaja me


vlerë përfshijnë investime në obligacione shtetërore të huaja (2,97%), letra shtetërore të huaja afatshkurtra me vlerë (0,14%), pjesë të fondeve investuese (24,24%) dhe investime në aksione (4,09%). Mjetet e tjera janë mjete monetare 0,86% dhe kërkesa 0,17%.

Grafiku 6.13. Struktura e investimeve në shtyllën e tretë me gjendje më 31.12.2025



Gjatë vitit 2025, katër fondet vullnetare pensionale investuan brenda kufijve maksimalë të investimit. Në grafikun 6.14 është paraqitur pjesëmarrja përqindjeje në portofol sipas klasave të mjeteve te SAVAd, KBPd, TRIGLAVd dhe VFPd, si dhe kufizimet ligjore me gjendjen më 31.12.2025.

Grafiku 6.14. Klasat e mjeteve në portofolin e FVP-ve të krahasuara me kufizimet ligjore




Fondet vullnetare pensionale kanë ekspozim më të madh të mjeteve në aksione nga emetuesit vendas (4,04%) krahasuar me fondet e detyrueshme pensionale, megjithëse ekspozimi ndaj aksioneve në emetuesit vendas është i ndryshëm te të gjitha fondet pensionale. Gjatë kësaj, ekspozimi ndaj aksioneve në emetuesit vendas është dukshëm më i madh te SAVAd (6,63%) dhe VFPd (9,27%) krahasuar me TRIGLAVd (1,75%) dhe KBPd (0,77%).

Në mënyrë krahasuese, lëvizja e vlerës së Indeksit të Bursës së Maqedonisë - MBI10, Indeksit të obligacioneve të Bursës së Maqedonisë - OMB dhe vlerat e njësive të kontabilitetit të fondeve vullnetare pensionale, gjatë vitit 2025, janë paraqitur në grafikun 6.15. Vlera e njësisë së kontabilitetit të SAVAd shënoi rritje prej 5,79%, njësia e kontabilitetit e KBPd rritje prej 4,60%, njësia e kontabilitetit e TRIGLAVd rritje prej 4,62% dhe njësia e kontabilitetit e VFPd shënoi rritje prej 5,17%. MBI10, gjatë vitit 2025, shënoi ulje prej 1,43%[2]. OMB, gjatë vitit 2025, shënoi rritje prej 4,30%.


[24]Lëvizjet janë paraqitur përmes ndryshimit të indekseve/njësive krahasuar me indeksin fillestar të barabartë me 100, më 31.12.2024
[25]Burimi: Bursa e Maqedonisë SHA Shkup – Buletini vjetor statistikor 2025.

Grafiku 6.15. Lëvizja krahasuese e vlerës së MBI10, OMB dhe vlerës së njësisë së kontabilitetit të FVP-ve, viti 2025




Edhe te fondet vullnetare pensionale, pjesa më e madhe e mjeteve në vitin 2025 ishte e investuar në letra shtetërore me vlerë, përkatësisht letra shtetërore vendase me vlerë (59,57% te SAVAd, 59,87% te KBPd, 47,69% te TRIGLAVd dhe 46,33% te VFPd) dhe në letra shtetërore të huaja me vlerë (2,03% te SAVAd, 4,12% te KBPd dhe 4,55% te VFPd). Menjëherë pas kësaj pasojnë investimet në instrumente nga emetuesit/shoqëritë aksionare nga sektori financiar (25,47% te SAVAd, 34,34% te KBPd, 38,91% te TRIGLAVd dhe 41,64% te VFPd). Në kuadër të këtij sektori, te SAVAd më e madhe është pjesëmarrja e pjesëve në fonde investimi të huaja dhe vendase (74,37%), pastaj pasojnë depozitat bankare vendase (13,29%), aksionet në bankat vendase (8,87%) dhe shërbimet financiare (3,47%). Te KBPd në kuadër të sektorit financiar mbizotëron pjesëmarrja e fondeve të huaja të investimit (93,72%), ndërsa pjesa tjetër i takon depozitave bankare vendase (6,28%). Edhe te TRIGLAVd në kuadër të sektorit financiar mbizotëron pjesëmarrja e fondeve të huaja dhe vendase të investimit (73,62%), ndërsa pjesa tjetër është e depozitave bankare vendase (21,88%) dhe aksione në bankat vendase (4,49%). Te VFPd në kuadër të sektorit financiar mbizotëron pjesëmarrja e fondeve të huaja dhe vendase të investimit (68,27%), ndërsa pjesa tjetër i takon depozitave bankare vendase (24,27%) dhe aksioneve në bankat vendase (7,46%). Përveç në sektorët e lartpërmendur, fondet vullnetare pensionale investojnë edhe në sektorë të tjerë: mallra bazë, farmaci, mallra konsumi, industri, teknologji informatike dhe shërbime komunikimi, por me pjesëmarrje shumë më të vogël (nga 0,77% deri në 3,03%). Struktura e investimeve të fondeve vullnetare pensionale, sipas sektorëve, është paraqitur në grafikun 6.16.

Grafiku 6.16. Struktura e investimeve të FVP-ve sipas sektorëve




Në lidhje me strukturën valutore të mjeteve të fondeve pensionale vullnetare, e paraqitur në grafikun 6.17., vërehet se në vitin 2025 nuk ka dallim të rëndësishëm krahasuar me strukturën valutore në vitin 2024. Përkatësisht, në vitin 2025 pjesa më e madhe e mjeteve të SAVAd është investuar në instrumente në valutë vendore (55,44%), ndërsa pjesëmarrja në instrumente në euro arrin në 21,41%. Te SAVAd pjesëmarrja në instrumente në denarë rritet në krahasim me vitin e kaluar, ndërsa pjesëmarrja në instrumente në euro zvogëlohet. Te BKPd pjesa më e madhe e mjeteve është investuar në instrumente në valutë vendore (47,24%), ndërsa pjesëmarrja në instrumente në euro arrin në 24,59%. Në vitin 2025, krahasuar me vitin e kaluar, te BKPd pjesëmarrja në instrumente në denarë rritet, ndërsa pjesëmarrja në instrumente në euro zvogëlohet. Pjesëmarrja e investimeve në dollarë amerikanë te SAVAd (22,76%) zvogëlohet, ndërsa te BKPd (28,16%) rritet në krahasim me vitin paraprak. Struktura valutore te SAVAd përfshin edhe një pjesë të vogël të instrumenteve në franga zvicerane prej 0,39%. Struktura valutore e TRIGLAVd ndryshon në krahasim me strukturën valutore të SAVAd dhe BKPd. Pesha e mjeteve të TRIGLAVd ende është në anën e mjeteve të investuara në instrumente në denarë (71,64%). Në vitin 2025 vërehet zvogëlim i pjesëmarrjes së instrumenteve në valutë të huaj, përkatësisht 3,73% e mjeteve të TRIGLAVd janë investuar në instrumente në euro, ndërsa 24,62% e mjeteve janë investuar në instrumente në dollarë amerikanë. Gjithashtu, edhe struktura valutore e VFPd ndryshon në krahasim me strukturat valutore të SAVAd, BKPd dhe TRIGLAVd. Te VFPd pjesa më e madhe e mjeteve është investuar në instrumente në valutë vendore (59,87%), më pas vijon pjesëmarrja në instrumente në euro (36,75%), ndërsa më e vogla është pjesëmarrja e instrumenteve në dollarë amerikanë (3,38%).

Grafikoni 6.17. Struktura valutore e mjeteve të FPV-ve, 2024-2025.



Nëse bëhet një krahasim me vendet që kanë sisteme pensionale të ngjashme me sistemin maqedonas, mund të vërehen ngjashmëri, por edhe dallime në portofolet investuese të fondeve pensionale vullnetare. Në grafikun 6.18. është dhënë krahasimi i investimeve, me gjendje më 31.12.2025, të fondeve pensionale vullnetare në RMV, me investimet e fondeve pensionale vullnetare në disa nga vendet e rajonit që kanë implementuar sigurim pensional vullnetar me financim kapital.

Grafikoni 6.18. Portofolet e fondeve pensionale vullnetare në disa vende dhe në RMV.



[26] *Burimi: www.hanfa.hr; www.fsc.bg; www.asfromania.ro dhe kalkulimiet vetanake*

Nëse portofolet e fondeve pensionale vullnetare shqyrtohen sipas instrumenteve, mund të vërehet se fondet pensionale në pothuajse të gjitha vendet kanë ekspozimin më të madh në obligacione dhe në letra të tjera me vlerë për të cilat garanton shteti ose pushteti lokal (në Rumani 64%, në Maqedoninë e Veriut 62%, në Bullgari 51%, ndërsa me përqindjen më të ulët në Kroaci 50%). Ekspozimi në depozita bankare është më i larti në Kroaci 4% dhe në Maqedoninë e Veriut 3%. Në Rumani dhe Bullgari ekspozimi në depozita është dukshëm më i ulët (rreth 1% në Rumani dhe më pak se 1% në Bullgari). Sa u përket investimeve në aksione dhe pjesëmarrje, përqindja më e madhe e mjeteve në aksione dhe pjesëmarrje është investuar te fondet pensionale në Bullgari (44%), Kroaci (37%), Maqedonia e Veriut (34%) dhe Rumani (31%). Fondet pensionale kanë investuar edhe në obligacione korporative, përkatësisht 4% te fondet pensionale në Bullgari dhe 3% në Rumani dhe në Kroaci. Në vitin 2025, investime në pasuri të paluajtshme, përveç fondeve pensionale në Bullgari (1%), kanë edhe fondet pensionale në Kroaci (0,2%) (në vendet e tjera, ky instrument zakonisht nuk lejohet). Sa i përket investimit jashtë vendit, fondet pensionale në Kroaci kanë ekspozim më të madh në investime të huaja me 37%, krahasuar me fondet pensionale në Maqedoninë e Veriut me 31%.

6.6. Mjetet neto, njësia kontabël dhe norma e kthimit të fondeve pensionale vullnetare

Mënyra e përllogaritjes së mjeteve neto, njësisë kontabël dhe kthimit të fondeve pensionale vullnetare është e njëjtë si për fondet pensionale të detyrueshme.

Ndryshimet e mjeteve të fondeve pensionale vullnetare, nga fillimi deri në fund të vitit, ndodhin për shkak të:

- hyrjes së kontributeve,
- daljes për shkak të kompensimeve dhe komisioneve të transaksioneve,
- daljes për shkak të pagesës së gabuar të kontributit të konvertuar,
- hyrjes për shkak të kalimit nga fondi tjetër pensional vullnetar (për personat që kanë qenë anëtarë në një fond tjetër dhe më pas kanë kaluar në fondin aktual),
- daljes për shkak të kalimit në fondin tjetër pensional vullnetar (personat që kanë qenë anëtarë të fondit përkatës dhe më pas kanë kaluar në fondin tjetër),
- daljes për shkak të pagesës së trashëgimisë,
- daljes për shkak të pagesës së kompensimeve pensionale (pagesa të njëhershme dhe të shumëfishta),
- fitimeve/humbjeve (të realizuara dhe të parealizuara) nga investimet.

Duke u nisur nga vlera e mjeteve neto në fund të vitit paraprak dhe duke marrë parasysh të gjitha ndryshimet e lartpërmendura, arrihet te vlera e mjeteve neto në fund të vitit (siç është paraqitur në tabelën 6.4.).

Tabela 6.4. Ndryshimet e mjeteve të fondeve pensionale vullnetare *(në milionë denarë)*

	SAVAd	BKPd	ТРИГЛАВд	VFPd	Gjithsej
Mjetet neto në 31.12.2024	2.119,35	2.059,77	19,35	166,14	4.364,61
Kontributet	281,30	291,77	14,01	37,97	625,06
Tarifat nga kontributet	6,44	7,07	0,19	0,96	14,67
Kontributet e zvogëluara për kompensimet nga kontributet	274,86	284,71	13,82	37,01	610,39
Kompensimi për transferim jo në kohë të kontributeve	0,04	2,47	0,00	0,29	2,80
Kompensimet nga mjetet	20,09	19,36	0,22	1,92	41,60
Shpenzimet për provizionet ndërmjetësuese	0,23	0,22	0,01	0,08	0,53
Transferimi nga fondi tjetër	11,18	1,97	4,66	58,95	76,75
Transferimi në fondin tjetër	36,49	34,68	0,08	5,51	76,75
Transferimi në Fondin e PIVS në bazë të shkëputjes së kontratës, kthimit të kontributit, pensionimit dhe ndërprerjes së anëtarësimit	2,47	2,97	0,00	0,00	5,45
Pagesa e trashëgimisë	69,67	76,58	0,28	3,85	150,38
Pagesa e pensionit të pleqërisë – tërheqje të programuara	148,64	118,33	1,36	13,40	281,72
Pagesa njëshe	128,32	98,74	1,14	11,39	239,59
Pagesa e pensionit familjar – tërheqje të programuara	2.425,04	2.328,49	38,61	263,83	5.055,97


Neto mjetet totale në fondet pensionale vullnetare, me gjendje më 31.12.2025, arrinin rreth 5,06 miliardë denarë ose rreth 82,21 milionë euro, që përfaqëson rreth 0,48% të BPV-së.

Në grafikonin 6.19. paraqiten vlerat e neto mjeteve në fund të të gjitha viteve dhe rritja e tyre në përqindje krahasuar me neto mjetet e vitit paraprak. Me këtë rast, mund të vërehet se neto mjetet e SAVAd dhe BKPd rriten me trend të ngjashëm. Rritja më e madhe vërehet në vitin 2011 krahasuar me vitin 2010, ndërsa rritja më e vogël vërehet në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021. Rritja vjetore e mjeteve të SAVAd dhe BKPd pas vitit 2023 tashmë ndjek trendin e pritur. Në vitin 2025 vërehet një rritje paksa më e ulët krahasuar me rritjen në vitin 2024.

Edhe te TRIGLAVd dhe VFPd vërehet një rritje e madhe e neto mjeteve në vitin e dytë të funksionimit të fondeve krahasuar me vitin e parë. Te TRIGLAVd në vitin 2025 vërehet rritje më e lartë, ndërsa te VFPd vërehet rritje më e ulët e mjeteve krahasuar me rritjen në vitin 2024.

[27] *Të dhënat për investimet jashtë vendit për Bullgarinë dhe Rumaninë, me gjendje më 31.12.2025, nuk janë të disponueshme në të dhënat e marra.*


Grafikoni 6.19. Rritja e neto mjeteve të SAVAd, BKPd, TRIGLAVd dhe VFPd në përqindje krahasuar me vitin paraprak.




Lëvizja e vlerës së aseteve neto dhe kontributeve kumulative, si dhe rritja e kontributeve të paguara dhe rritja e aseteve neto në SAVAd dhe KBPd tregohen në Grafikun 6.20 dhe Grafikun 6.21. Rritja e aseteve neto të fondeve të pensioneve vullnetare nënkuptohet nga rritja e kontributeve të paguara dhe rezultateve të investimeve. Ulja e rritjes në vitin 2022, në vitin 2023 vërehet një rritje e re në rritjen e aseteve neto. Pjesa e kontributeve kumulative në totalin e aseteve neto gjatë viteve të para është dukshëm e madhe, dhe më pas zvogëlohet me përjashtim të vitit 2022.

[28] *Burimi për BPV-në: Enti Shtetëror i Statistikave – Komunikatë për Shtyp - Produkti i Brendshëm Bruto, për vitin 2025*


Grafiku 6.20. Rritja e aseteve neto krahasuar me rritjen e kontributeve të paguara në SAVAd




Grafiku 6.21. Rritja e aseteve neto krahasuar me rritjen e kontributeve të paguara në BKPd.



Grafiku 6.22. Rritja e aseteve neto krahasuar me rritjen e kontributeve të paguara në TRIGLAVd



Grafiku 6.23. Rritja e aseteve neto krahasuar me rritjen e kontributeve të paguara në FVPd



Te SAVAd, pas rritjes së zvogëluar të mjeteve neto në vitin 2022 (5%), në vitin 2023 dhe 2024 vërehet sërish rritje e rritjes së mjeteve neto, ndërsa në vitin 2025 rritja ngadalësohet (14%). Për sa i përket kontributeve të paguara, pas zvogëlimit të kontributeve të paguara për 1% në vitin 2022, në vitin 2023 vërehet rritje e kontributeve të paguara, ndërsa pas rritjes së ngadalësuar në vitin 2024, në vitin 2025 vërehet rritje e rritjes krahasuar me vitin e kaluar (17%). Gjithashtu, edhe te KBPd, pas rritjes së zvogëluar në vitin 2022, në vitin 2023 dhe 2024 vërehet rritje e rritjes së mjeteve neto, ndërsa në vitin 2025 rritja ngadalësohet (13%). Për sa i përket kontributeve të paguara, pas zvogëlimit në vitin 2022 dhe 2023, në vitin 2024 vërehet rritje e cila në vitin 2025 zvogëlohet dhe arrin në 11%.


Lëvizja e vlerës së mjeteve neto dhe e kontributeve kumulative, si dhe rritja e kontributeve të paguara dhe rritja e mjeteve neto të TRIGLAVd, për periudhën 2021-2025, dhe të VFPd për tri vitet e para të punës, 2022-2025, janë paraqitur në grafikun 6.22 dhe grafikun 6.23, përkatësisht. Te TRIGLAVd vërehet rritje domethënëse e rritjes së mjeteve neto (100%) dhe rritje e kontributeve të paguara në vitin 2025 krahasuar me vitin 2024 për 256%. Rritja e mjeteve neto të TRIGLAVd i detyrohet më shumë kontributeve të paguara sesa mjeteve të transferuara nga fondet e tjera pensionale në TRIGLAVd në bazë të marrëveshjeve të lidhura për kalim në TRIGLAVd. Te VFPd vërehet rritje e mjeteve neto (59%) dhe e kontributeve të paguara (34%) në vitin 2025 krahasuar me vitin 2024. Rritja e mjeteve neto të VFPd, përveç faktit se është implikuar nga rritja e kontributeve të paguara, i detyrohet më shumë edhe mjeteve të transferuara nga fondet e tjera pensionale në VFPd në bazë të marrëveshjeve të lidhura për kalim në VFPd.

Lëvizja e vlerës së njësive të kontabilitetit të fondeve vullnetare pensionale, nga fillimi i punës së fondeve vullnetare pensionale, deri më 31.12.2025, është dhënë në tabelën 6.5, në grafikun 6.24 dhe në grafikun 6.25. Gjatë kësaj, nga fillimi i punës së SAVAd dhe KBPd vërehet trend rritës i njësive të kontabilitetit. Më 1.3.2021 filloi me punë fondi i tretë vullnetar pensional, TRIGLAVd. Më 18.10.2022 filloi me punë fondi i katërt vullnetar pensional, VFPd. Në vitin 2025, edhe pse i ngadalësuar, vazhdoi trendi i rritjes së vlerave të njësive të kontabilitetit të katër fondeve vullnetare pensionale (5,79% te SAVAd, 4,60% te KBPd, 4,62% te TRIGLAVd dhe 5,17% te VFPd). Rritja e ngadalësuar i detyrohet zvogëlimit të shumës së njësisë së kontabilitetit në fund të tremujorit të parë dhe fillimit të tremujorit të dytë (për shkak të lëvizjeve në tregjet financiare të huaja), pas së cilës pason rritje graduale e njësisë. Megjithatë, fondet pensionale sipas natyrës së tyre, punojnë në afat të gjatë, prandaj performancat e tyre duhet të vlerësohen në afat të gjatë.


Tabela 6.5. Vlera e njësisë së kontabilitetit nga fillimi i ekzistencës së FVP-ve

	Vlera e njësisë së kontable			
Data	SAVAd	BKPd	TRIGLAVd	FVPd
15.09.2009	100,000000			
21.12.2009	102,815757	100,000000		
31.12.2009	103,061825	100,204385		
31.12.2010	107,592926	106,891617		
31.12.2011	111,854726	112,639593		
31.12.2012	118,742851	119,129537		
31.12.2013	130,511147	129,015451		
31.12.2014	140,946772	139,908803		
31.12.2015	147,535595	146,709341		
31.12.2016	154,578083	154,465341		
31.12.2017	164,155073	162,989756		
31.12.2018	169,649887	163,696595		
31.12.2019	188,197689	181,404697		
31.12.2020	191,209810	188,085163		
31.12.2021	210,750156	207,793725	103,476074	
31.12.2022	204,936103	201,600542	101,945390	98,791716
31.12.2023	222,263888	214,618876	108,442676	118,645563
31.12.2024	245,499550	234,952226	118,666065	122,445954
31.03.2025	243,276704	232,350023	117,780147	121,267863
30.06.2025	246,104713	236,180587	119,610100	123,878798
30.09.2025	255,301374	242,505924	122,796356	126,886844
31.12.2025	259,704656	245,749635	124,143948	128,777921

Grafiku 6.24. Vlera e njësisë së kontabilitetit nga fillimi i ekzistencës së FVP-ve



Grafiku 6.25. Vlera e njësisë së kontabilitetit të FVP-ve në vitin 2025



Kthimi i fondeve vullnetare pensionale sipas periudhave, i reduktuar në nivel vjetor, është paraqitur në tabelën 6.6.

Tabela 6.6. Kthimi i FVP-ve

Periudha	SAVAd		BKPd		TRIGLAVd		VFPd	
	Në vlerë nominale	Në vlerë reale	Në vlerë nominale	Në vlerë reale	Në vlerë nominale	Në vlerë reale	Në vlerë nominale	Në vlerë reale
31.12.2009 - 31.12.2010	4,40%		6,67%					
31.12.2009 – 31.12.2011	4,18%		6,02%					
31.12.2009 - 31.12.2012	4,83%		5,93%					
31.12.2009 – 31.12.2013	6,08%	3,00%	6,52%	3,42%				
31.12.2009 – 31.12.2014	6,46%	4,09%	6,90%	4,52%				
31.12.2009 - 31.12.2015	6,16%	4,25%	6,56%	4,64%				
31.12.2009 - 31.12.2016	5,96%	4,36%	6,37%	4,77%				
31.12.2010 - 31.12.2017	6,22%	4,72%	6,21%	4,71%				
31.12.2011 - 31.12.2018	6,13%	4,91%	5,48%	4,27%				
31.12.2012 – 31.12.2019	6,80%	6,22%	6,19%	5,62%				
31.12.2013 - 31.12.2020	5,60%	4,90%	5,53%	4,82%				
31.12.2014 - 31.12.2021	5,91%	4,41%	5,81%	4,31%				
31.12.2015 – 31.12.2022	4,80%	0,77%	4,64%	0,61%				
30.06.2021 – 31.12.2022					0,84%	-11,60%		
31.12.2016 – 31.12.2023	5,32%	0,71%	4,81%	0,22%				
30.06.2021 – 31.12.2023					3,01%	-6,16%		
31.12.2022 - 31.12.2023							8,20%	4,42%
31.12.2017 - 31.12.2024	5,91%	1,00%	5,36%	0,47%				
30.06.2021 - 31.12.2024					4,80%	-3,14%		
31.12.2022 - 31.12.2024							11,31%	7,03%
31.03.2018 - 31.03.2025	5,74%	0,89%	5,26%	0,44%				
30.06.2021 - 31.03.2025					4,27%	-2,96%		
31.12.2022 - 31.03.2025							9,54%	6,10%
30.06.2018 - 30.06.2025	5,33%	0,26%	5,12%	0,06%				
30.06.2021 - 30.06.2025					4,40%	-3,12%		
12.31.2022 - 30.06.2025							9,48%	5,13%
30.09.2018 - 30.09.2025	5,49%	0,25%	5,23%	0,00%				
30.06.2021 - 30.09.2025					4,78%	-2,58%		
31.12.2022 - 30.09.2025							9,53%	5,16%
31.12.2018 - 31.12.2025	6,27%	0,88%	5,97%	0,60%				
30.06.2021 - 31.12.2025					4,76%	-2,35%		
31.12.2022 - 31.12.2025							9,23%	4,99%
Fillimi*– 31.12.2025	5,97%	2,75%	5,76%	2,49%	4,57%	-2,52%	8,30%	4,23%

**Fillimi për SAVAd është 15.7.2009, për KBPd është 21.12.2009, për TRIGLAVd është 1.3.2021 dhe për VFPd është 18.10.2022.*

[29]TRIGLAVd dhe VFPd janë përfshirë në analizat krahasuese për kthim me kthim të llogaritur për periudhat përkatëse, konform rregullores, pasi ekzistojnë më gjatë se 12 muaj, por më shkurt se 84 muaj.

[30]Deri në miratimin e ndryshimeve të Ligjit për sigurimin pensional me financim kapital vullnetar, nga janari i vitit 2013, kthimi i një fondi vullnetar pensional llogaritej për një periudhë prej 3 vitesh, vetëm në shumë nominale.


Kthimi i llogarisë vullnetare individuale dhe/ose profesionale është i ndryshueshëm dhe varet nga kthimi i fondit vullnetar pensional dhe nga kompensimet e arkëtuara nga shoqëria. Kthimi, përkatësisht fitimi, është parametër që realisht nuk mund të parashikohet, sepse varet nga kushtet e tregut të kapitalit dhe në ekonominë e përgjithshme.

Kthimi i fondeve vullnetare pensionale llogaritet në të njëjtën mënyrë dhe sipas të njëjtës formulë si edhe kthimi i fondeve të detyrueshme pensionale.

Duke pasur parasysh natyrën afatgjate të sigurimit pensional, është mirë të llogaritet edhe kthimi i fondeve vullnetare pensionale nga fillimi i ekzistencës së tyre, i reduktuar në nivel vjetor, i cili për SAVAd arrin në 5,97% në shumë nominale, përkatësisht 2,75% në shumë reale; për KBPd 5,76% në shumë nominale, përkatësisht 2,49% në shumë reale; për TRIGLAVd 4,57% në shumë nominale, përkatësisht 2,52% në shumë reale; ndërsa për VFPd kthimi në shumë nominale arrin në 8,30%, përkatësisht 4,23% në shumë reale.

Lëvizja e kthimit në shumë nominale, sipas periudhave, mund të shihet në grafikun 6.26, ku janë paraqitur kthimet sipas periudhave, nga 31.12.2009 deri më 31.12.2025, sipas fondeve. Në fillim, vërehet rritje e kthimit, kështu që, në fund të gjysmës së parë të vitit 2011, vërehen kthime të larta te të dy fondet vullnetare pensionale, ndërsa në fund të vitit 2011, pati rënie të kthimeve. Pastaj, në vitet në vijim pason rritje graduale e kthimit deri në mesin e vitit 2015, pas së cilës vërehet rënie e kthimit, deri në mesin e vitit 2016, dhe pastaj sërish vërehet rritje e kthimit, duke përfshirë fundin e vitit 2016. Në vitin 2019 vërehet rritje e kthimit krahasuar me kthimin në fund të vitit 2018. Në vitin 2020 vërehen kthime më të vogla krahasuar me vitin 2019 te SAVAd dhe KBPd, kryesisht për shkak të gjendjeve të pafavorshme në tregjet financiare në kushte të pandemisë së virusit Korona. Pas rënies së kthimeve në vitin 2022 për shkak të krizës globale të shkaktuar nga konflikti ushtarak midis Ukrainës dhe Rusisë, në vitin 2023 vërehet rritje e vogël e kthimeve te SAVAd dhe KBPd. TRIGLAVd në vitet fillestare të punës së tij dhe në rrethana të jashtëzakonshme për shkak të gjendjeve të pafavorshme në tregjet financiare shënoi kthim në shumë nominale më të vogël se zero, i cili tashmë në periudhën pasuese u kompensua dhe në vitin 2023 vërehet rritje e kthimit krahasuar me vitin 2022. VFPd në vitin e parë të punës së tij shënon kthim të lartë. Në vitin 2024 vërehet rritje e kthimit te të gjitha fondet pensionale. Në vitin 2025 vërehet zvogëlim i kthimit te të gjitha fondet pensionale krahasuar me kthimin në vitin 2024.

Grafiku 6.26. Kthimi i FVP-ve (në shumë nominale)




Lëvizja e kthimit në shumë nominale dhe reale, në periudhën nga viti 2013 deri në vitin 2024 (në nivel vjetor) dhe në vitin 2025 (në nivel tremujor), sipas periudhave përkatëse të definuara me ligj, të konvertuara në normë vjetore ekuivalente të kthimit, sipas fondit vullnetar pensional, mund të shihen në grafikun 6.27. Në këtë grafik është paraqitur edhe lëvizja e kthimit në shumë nominale dhe reale të TRIGLAVd dhe VFPd, për periudhat përkatëse në përputhje me rregulloren, pasi ato ekzistojnë më gjatë se 12 muaj, por më shkurt se 84 muaj.

Në vitin 2025, kthimi në shumë nominale shënon rritje si te SAVAd (nga 5,74% në 6,27%) ashtu edhe te KBPd (nga 5,26% në 5,97%), ndërsa kthimi në shumë reale te SAVAd mbetet pothuajse në të njëjtin nivel (0,88%), përderisa te KBPd shënon rritje (nga 0,44% në 0,60%). Gjatë kësaj, te fondet pensionale që ekzistojnë më shumë se shtatë vite, shuma më e vogël e kthimit në shumë nominale është shënuar në tremujorin e dytë, ndërsa shuma më e vogël e kthimit në shumë reale është shënuar në tremujorin e tretë.

Gjithashtu, kthimi i fondit të tretë vullnetar pensional, TRIGLAVd, i cili filloi punën në mars të vitit 2021, në vitin 2025 shënoi rritje në shumë nominale (nga 4,27% në 4,76%) dhe në shumë reale (nga -2,96% në -2,35%). Fondi i katërt vullnetar pensional, VFPd, në fund të vitit 2025 realizoi rritje të kthimit në shumë nominale (nga 9,54% në 9,23%) dhe ulje të kthimit në shumë reale (nga 6,10% në 4,99%).

Në periudhën e shqyrtuar (2013 - 2025), ndryshimi i nivelit të shpenzimeve të jetesës në periudhat llogaritëse, të reduktuara në nivel vjetor, deri në vitin 2019 shënon ulje, gjë që ndikon në përafrimin gradual të kthimeve në shumë reale drejt kthimeve në shumë nominale, ndërsa në periudhën pas vitit 2019 (veçanërisht në vitin 2022) shënon rritje, gjë që ndikon në largimin gradual të kthimeve në shumë reale nga kthimet në shumë nominale.

Grafiku 6.27. Kthimi në shumë nominale dhe reale të FVP-ve, 2013 – 2025



Kthimi shtatëvjeçar në nivel të sigurimit pensional me financim kapital vullnetar për periudhën 31.12.2018 – 31.12.2025, i llogaritur përmes ndryshimit të mesatares së ponderuar të njësive të kontabilitetit të fondeve vullnetare pensionale, i reduktuar në nivel vjetor, është 5,69% në shumë nominale, përkatësisht 0,33% në shumë reale.


Në fund të vitit 2025 vërehet një kthim më i lartë në shumë nominale krahasuar me fundin e vitit 2024, me tendencë për të arritur kthimin e realizuar në fund të vitit 2021.

Kthimi në shumë reale në fund të vitit 2025 mbetet në të njëjtin nivel si në fund të vitit 2024, gjë që do të thotë se rritja vjetore e nivelit të shpenzimeve të jetesës në periudhat llogaritëse ende ndikon ndjeshëm në kthimin në shumë reale.

Të dhënat për kthimin shtatëvjeçar në nivel të sigurimit pensional me financim kapital vullnetar, të llogaritura përmes ndryshimit të mesatares së ponderuar të njësive të kontabilitetit të fondeve vullnetare pensionale, për çdo tremujor në periudhën 2021 deri në vitin 2025, janë paraqitur në grafikun 6.28.

[31] *Vlera mesatare është llogaritur si mesatare e ponderuar e njësive të kontabilitetit të fondeve vullnetare pensionale në lidhje me mjetet neto të fondeve vullnetare pensionale*

Grafiku 6.28. Kthimi mesatar i ponderuar në shumë nominale dhe reale të FVP-ve, 2021 – 2025



6.7. Kompensimet te fondet vullnetare pensionale

Për kryerjen e funksioneve të tyre për menaxhimin me mjetet e fondit vullnetar pensional, vlerësimin e mjeteve, anëtarësimin, mbajtjen e llogarive vullnetare individuale dhe profesionale të anëtarëve dhe për njoftimin e anëtarëve, si dhe për pagimin e kompensimeve për MAPAS-in dhe për ruajtësin e pasurisë, shoqëritë, në përputhje me Ligjin për sigurimin pensional me financim kapital vullnetar, arkëtojnë kompensim nga kontributet, kompensim nga mjetet dhe kompensim për kalim.

Kompensimi nga kontributet arkëtohet si përqindje nga çdo kontribut i paguar në fondin vullnetar pensional, para shndërrimit të tij në njësi kontabiliteti. Ky kompensim shoqëria e arkëton në përqindje të njëjtë nga të gjithë anëtarët e fondit vullnetar pensional, përveç në rastin e anëtarëve që janë pjesëmarrës në skemë pensionale profesionale ose në rast të anëtarësimit shumëvjeçar. Kompensimi mujor nga mjetet përfaqëson përqindje nga vlera e mjeteve neto të fondit vullnetar pensional, i cili llogaritet në çdo datë të vlerësimit të mjeteve të fondit vullnetar pensional (në përputhje me nënligjin në fuqi, datë e vlerësimit është çdo ditë) dhe arkëtohet një herë në muaj. Kompensimi për kalim arkëtohet në rast të kalimit të anëtarit nga një fond vullnetar pensional në një fond tjetër vullnetar pensional, me kusht që anëtari që kalon të ketë

qenë anëtar në fondin ekzistues vullnetar pensional më pak se një vit.

Ligji i përcakton shumat maksimale, ndërsa e drejta e shoqërive është t'i përcaktojnë shumat e llojeve të veçanta të kompensimeve në kuadër të maksimumit ligjor.
Kompensimet që i arkëtonin shoqëritë që menaxhojnë me fondet vullnetare pensionale në RSM, për vitin 2025, janë paraqitur në tabelën 6.7.

Tabela 6.7. Kompensimet që i arkëtonin shoqëritë që menaxhojnë me fonde vullnetare pensionale në vitin 2025

Lloj i kompensimit	SAVA	BK e pare	TRIGLAV	VFPd
Kompensimi nga kontributi*	2,50%[32]	2,50% [33]	2,50%[34]	2,90%
Kompensimi mujor nga vlera e mjeteve neto të fondit vullnetar pensional	0,075%35	0,075%36	0,075%	0,075%
Kompensimi për kalim				
Numri i ditëve**	Shuma e kompensimit për kalim	Shuma e kompensimit për kalim	Shuma e kompensimit për kalim	Shuma e kompensimit për kalim
Numri i ditëve ≤ 360	10 euro	10 euro	10 euro	10 euro
Numri i ditëve > 360	Nuk arkëtohet kompensim për kalim	Nuk arkëtohet kompensim për kalim	Nuk arkëtohet kompensim për kalim	Nuk arkëtohet kompensim për kalim

**Për anëtarët që janë pjesëmarrës në një skemë pensionale profesionale, shoqëria mund të përcaktojë një shumë më të ulët të këtij kompensimi.*
***Numri i ditëve përcaktohet në bazë të numrit të ditëve nga data kur anëtari ka fituar statusin e anëtarit në fondin ekzistues vullnetar pensional deri në datën e nënshkrimit të kontratës për anëtarësim me fondin e ardhshëm vullnetar pensional.*

Lartësia e kompensimeve nga kontributet, të cilat janë arkëtuar nga fillimi i punës së shtyllës së tretë, duke përfshirë vitin 2025, është paraqitur në tabelën 6.8.

Tabela 6.8. Lartësia e kompensimeve nga kontributet të cilat i arkëtonin shoqëritë pensionale në shtyllën e tretë

Shoqëria pensionale	Vlera	Data e zbatimit
SAVA	5,25%	Nga fillimi me punë i fondit (15 korrik 2009)
	3,80%	Prej me 1 mars 2011
	2,90%	Prej me 1 janar 2017
	2,50%	Prej me 1 maj 2021
BK e parë	5,50%	Nga fillimi me punë i fondit (21 dhjetor 2009)
	4,00%	Prej me 24 prill 2010
	2,90%	Prej me 1 korrik 2013
	2,50%	Prej me 1 janar 2023
TRIGLAV	2,90%	Prej me 1 mars 2021
	2,50%	Prej me 29 prill 2025
VFP	2,90%	Nga fillimi me punë i fondit (18 tetor 2022)

Nga fillimi i punës së fondeve vullnetare pensionale, shoqëritë pensionale SAVA dhe BK shoqëria e parë pensionalee kanë ulur tri herë kompensimin nga kontributet. Kompensimi nga mjetet që nga fillimi i punës së shtyllës së tretë ka qenë 0,15% në muaj nga vlera e mjeteve neto të fondit vullnetar pensional. Gjithashtu, në vitin 2011, të dy shoqëritë e ulën edhe kompensimin nga mjetet, përkatësisht në 0,100% te SAVA dhe në 0,075% te KB Prvo. Në vitin 2021, SAVA edhe një herë e uli kompensimin nga mjetet dhe tani i njëjti arrin në 0,075%. Në vitin 2025, edhe TRIGLAV e uli kompensimin nga kontributet.

Arkëtimi i kompensimeve (në mijëra denarë), nga ana e shoqërive që menaxhojnë me fondet vullnetare pensionale, gjatë vitit 2025, sipas muajve dhe sipas llojit të kompensimit, është dhënë në tabelën 6.9.

[32] *Nga 1 Maj 2021 (mëherët ishte 2,90%).*
[33] *Nga 1 Janar 2023 (mëherët ishte 2,90%).*
[34] *Nga 29 Prill 2025 (mëherët ishte 2,90%).*
[35] *Nga 1 Maj 2021 (mëherët ishte 0,100%).*
[36] *Nga 1 Janar 2011 (mëherët ishte 0,15%).*

Tabela 6.9. Arkëtimi i kompensimeve nga ana e shoqërive në vitin 2025 (në mijëra denarë)

	Gjithsej 2024	Jan.	Shk.	Mar.	Prill	Maj		Korr.		Shtat.	Tet.	Nën.	Dhje.	Gjithsej 2025
SAVAd Gjithsej	22.805	2.018	2.062	2.117	2.073	2.195	2.007	2.200	2.119	2.112	2.411	2.334	2.887	26.535
Nga Kontributet	5.446	411	436	509	498	574	366	533	425	395	657	555	1.086	6.445
Nga mjetet	17.359	1.608	1.626	1.608	1.576	1.621	1.641	1.667	1.694	1.717	1.753	1.779	1.801	20.090
BKPd Gjithsej	23.142	2.012	2.318	2.108	2.137	1.966	2.049	2.217	2.000	2.143	2.244	2.143	3.096	26.433
Nga Kontributet	6.363	450	738	549	616	395	459	606	367	495	567	449	1.379	7.069
Nga mjetet	16.778	1.562	1.581	1.559	1.522	1.571	1.590	1.611	1.633	1.648	1.677	1.695	1.717	19.365
TRIGLAV Gjithsej	237	21	23	26	47	26	29	32	27	36	45	32	70	413
Nga Kontributet	110	6	7	10	31	9	12	14	9	17	24	9	46	195
Nga mjetet	127	15	15	16	16	17	17	17	18	19	21	23	24	218
VFPd Gjithsej	1.792	196	186	242	201	211	205	205	251	228	231	234	497	2.885
Nga Kontributet	730	70	53	102	58	61	51	43	83	46	44	45	303	961
Nga mjetet	1.062	126	132	139	143	150	154	161	168	182	186	189	194	1.924

Komisionet e transaksionit, në lidhje me transaksionet për fitimin ose për transferimin e mjeteve të fondit vullnetar pensional, paguhen nga mjetet e fondit vullnetar pensional, ndërsa arkëtohen nga persona juridikë të zgjedhur të cilët kryejnë shërbime me letra me vlerë, brenda dhe jashtë vendit. Komisionet e transaksionit llogariten si përqindje e vlerës së çdo transaksioni të realizuar.

Gjatë vitit 2025, nga SAVAd janë arkëtuar gjithsej rreth 225 mijë denarë komisione transaksioni, nga KBPd janë arkëtuar gjithsej rreth 221 mijë denarë, nga TRIGLAVd janë arkëtuar gjithsej 6 mijë denarë, ndërsa nga VFP janë arkëtuar 81 mijë denarë komisione transaksioni.

6.8. Pagesa e kompensimeve pensionale nga sigurimi pensional me financim kapital vullnetar

Kushtet për fitimin e së drejtës për kompensim pensional dhe mënyra e pagesës së kompensimit pensional nga shtylla e tretë janë më liberale në krahasim me shtyllën e dytë, megjithatë duhet pasur parasysh se ato janë kursime për periudhën pas pensionimit. Përkatësisht, mjetet mund të tërhiqen më së hershtmi dhjetë vjet para moshës për fitimin e së drejtës për pension pleqërie, në përputhje me Ligjin për sigurimin pensional dhe invalidor, që për momentin do të thoshte më së hershtmi në moshën 54 vjeç për burrat, përkatësisht 52 vjeç për gratë. Gjithashtu, mjetet mund të tërhiqen në rast se te anëtari është konstatuar paaftësi e përgjithshme për punë, nga ana e Komisionit për vlerësimin e aftësisë për punë, pranë Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut, pa marrë parasysh moshën. Në rast të vdekjes së një anëtari të fondit vullnetar pensional, mjetet nga llogaria e anëtarit bëhen pjesë e masës trashëgimore dhe me to veprohet në përputhje me Ligjin për trashëgimi.

Mjetet nga shtylla e tretë përdoren sipas zgjedhjes së anëtarit në llojet e mëposhtme të kompensimeve pensionale:

- pagesë njëshe ose shumëshe e mjeteve;
- anuitet pensional që paguhet nga një shoqëri sigurimi e autorizuar për këtë qëllim;
- tërheqje të programuara që paguhen nga shoqëria që menaxhon me fondin vullnetar pensional, ose
- kombinim i opsioneve të lartpërmendura.

Sigurimi i pensioneve dhe kompensimeve pensionale, të cilat paguhen nga shtylla e dytë dhe e tretë, është rregulluar me Ligjin për pagesën e pensioneve dhe kompensimeve pensionale nga sigurimi pensional me financim kapital.


Në vitin 2025 janë realizuar 424 kompensime pensionale dhe pagesa nga shtylla e tretë. Pjesa më e madhe e kompensimeve pensionale të realizuara ishin në raste të kritereve të plotësuara të moshës, kjo pjesërisht si pagesa njëshe, e një pjesë e vogël edhe si pagesa shumëshe. Në vitin 2025 një anëtar ka realizuar kompensim pensional si pagesë njëshe për bazë invaliditeti, ndërsa një pjesë e pagesave në shtyllën e tretë ishin në rast të vdekjes së anëtarit, me pagesë të trashëgimisë. Pasqyrë e detajuar e kompensimeve pensionale dhe pagesave të realizuara për anëtarët e shtyllës së tretë, sipas fondeve vullnetare pensionale dhe llojit të llogarisë, për vitin 2025, janë dhënë në tabelën 6.10.

Tabela 6.10. Kompensimet pensionale dhe pagesat e realizuara të anëtarëve nga shtylla e tretë në vitin 2025

Lloji i kompensimit pensional dhe pagesës / Fondi vullnetar pensional	SAVAd		BKPd		TRIGLAVd		FVPd		GJithsej
	Xhiro individuale	Xhiro profesionale	Xhiro individuale	Xhiro profesionale	Xhiro individuale	Xhiro profesionale	Xhiro individuale	Xhiro profesionale	
Pleqëria - pagesë njëshe	107	66	58	145	2	0	1	3	382
Pleqëria - pagesë shumëshe	8	2	5	9	0	0	0	0	24
Invaliditeti - pagesë njëshe	1	0	0	0	0	0	0	0	1
Trashëgimia	4	2	5	10	0	0	0	0	21
Gjithsej	120	70	68	164	0	0	1	1	424

Në grafikun 6.29 është paraqitur struktura e kompensimeve pensionale dhe pagesave të realizuara për anëtarët e shtyllës së tretë nga fillimi i punës së shtyllës së tretë, sipas viteve, deri në fund të vitit 2025. Numri i pagesave është i vogël, sepse sistemi është ende i ri dhe anëtarët janë persona relativisht të rinj. Pjesa më e madhe e pagesave janë pagesa njëshe në rastet e kritereve të plotësuara të moshës, ndërsa pastaj vijnë pagesat në rastet e vdekjes së anëtarit si pagesë e trashëgimisë. Ekziston edhe një numër i vogël i pagesave njëshe për bazë invaliditeti, si dhe pagesa shumëshe për bazë të kritereve të plotësuara të moshës.

Grafiku 6.29. Struktura e pensioneve dhe pagesave të realizuara nga shtylla e tretë që nga fillimi i punës



7. Marketingu dhe agjentët e shoqërive pensionale

Për mbrojtjen e interesave të anëtarëve ekzistues, anëtarëve të ardhshëm dhe anëtarëve të pensionuar të sigurimit pensional me financim kapital, si dhe për të siguruar informim të drejtë dhe objektiv të publikut, marketingu zhvillohet në një mjedis të rregulluar me ligj dhe akte nënligjore.

Gjatë vitit 2025 u organizua provimi për agjentë në pesë sesione provimi dhe, nga gjithsej 191 kandidatë të pranishëm, provimin e kaluan 104 kandidatë, ose 54% e kandidatëve të pranishëm. Gjatë vitit 2025 u krye regjistrimi i gjithsej 58 agjentëve, ndërsa riregjistrimi u krye për 2 agjentë.

Në vitin 2025, numri mesatar i kontratave të lidhura për agjent u ul krahasuar me vitin 2024. Numri i agjentëve që kanë lidhur kontrata gjatë vitit 2025 u rrit lehtë te BK e Parë, ndërsa u ul lehtë te SAVA dhe te TRIGLLAV.

Për mbrojtjen e interesave të anëtarëve ekzistues dhe të ardhshëm dhe të anëtarëve të pensionuar të sigurimit pensional me financim kapital, si dhe për sigurimin e informimit të drejtë dhe objektiv të opinionit publik, marketingu kryhet në një mjedis të rregulluar, të përcaktuar me ligj dhe me akte nënligjore.

Punët e marketingut janë të gjitha aktivitetet që kanë për qëllim reklamimin e shoqërive pensionale dhe të fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale, si dhe informimin dhe lidhjen e kontratave për anëtarësim në fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale dhe për pagesën e mjeteve nga fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale. Këto aktivitete përfshijnë: reklamimin e punës së shoqërive pensionale dhe të fondeve pensionale me të cilat ato menaxhojnë, informimin për karakteristikat e sigurimit pensional me financim kapital të detyrueshëm dhe vullnetar, informimin për kompensimet dhe komisionet e transaksionit, informimin për kthimet e fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale, informimin për portofolet e investimeve të fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale, informimin për llogaritë individuale, llogaritë vullnetare individuale dhe për llogaritë profesionale, anëtarësimin dhe kalimin e anëtarëve nga një fond i detyrueshëm pensional në tjetrin, anëtarësimin dhe kalimin e anëtarëve nga një fond vullnetar pensional në tjetrin, lidhjen e kontratave për tërheqje të programuara, kontratave për pagesë njëshe dhe kontratave për pagesa shumëshe, si dhe aktivitete të tjera për reklamim dhe sigurim të informacioneve lidhur me punën e shoqërive pensionale dhe fondeve pensionale. Shoqëria pensionale mund të kryejë punë të marketingut të fondit pensional në hapësirat e saj, në hapësirat e bashkëpunëtorëve të saj afaristë për marketing ose jashtë tyre, drejtpërdrejt ose përmes llojit përkatës të komunikimit (telefon, faks, internet). Hapësirat për marketing duhet të plotësojnë kushte të caktuara të përcaktuara me ligj.

Për t'i mundësuar MAPAS-it që ta realizojë funksionin kontrollues mbi materialet për marketing, shoqëria pensionale është e obliguar t'ia dorëzojë MAPAS-it, në fotokopje ose në medium përkatës të jashtëm, çdo material të publikuar për marketing, në afat prej tri ditësh pas publikimit të tij. Në rast se MAPAS-i konsideron se ndonjë reklamë, ose material tjetër i shkruar, mund të shkaktojë hutim, mund me vendim ta ndalojë publikimin ose shpërndarjen e mëtejshme dhe të urdhërojë publikimin e ndryshimit të atij materiali, në afat që vetë do ta përcaktojë.

Personi që kryen marketing, përkatësisht agjenti, mund të jetë person i punësuar në shoqëri pensionale ose person tjetër që është angazhuar me kontratë nga ana e shoqërisë pensionale. Agjenti mund të kryejë punë të marketingut të fondeve pensionale dhe/ose të lidhë kontrata për anëtarësim ose për pagesë të mjeteve, vetëm për fondet pensionale me të cilat menaxhon shoqëria pensionale në të cilën ai është i punësuar ose është angazhuar me kontratë. Agjenti është i obliguar të jetë i pranishëm gjatë lidhjes së kontratës për anëtarësim në fond pensional, kontratës për kalim, kontratës për tërheqje të programuara, kontratës për pagesë njëshe dhe kontratës për pagesa shumëshe dhe është i obliguar ta nënshkruajë kontratën e tillë. Agjenti është i obliguar të gjitha kontaktet me anëtarin, me anëtarin e pensionuar ose me personat që kanë të drejtë të bëhen anëtarë dhe anëtarë të pensionuar të fondit pensional, t'i kryejë personalisht dhe nuk guxon të lidhë kontrata përmes personit tjetër. Gjithashtu, agjenti ka rol të rëndësishëm edhe gjatë zgjedhjes së llojit të pagesës së pensionit nga sigurimi pensional me financim kapital, nga ana e anëtarit, dhe është i obliguar personalisht t'i prezantojë ofertat për pensionet e projektuara të ardhshme të anëtarit i cili ka dorëzuar kërkesë për kuotim, me shpjegim të detajuar të karakteristikave dhe të supozimeve të përdorura për të gjitha llojet e pagesave të pensioneve.

Personi mund të kryejë punë të marketingut, vetëm pas regjistrimit të tij në Regjistrin e agjentëve që e udhëheq MAPAS-i. MAPAS-i i përcakton mënyrën dhe procedurën për dhënien e provimit për agjentë dhe mënyrën dhe procedurën për regjistrimin e personit në Regjistrin e agjentëve. Gjatë vitit 2025, u organizua provim për agjentë në pesë sesione provimi dhe nga gjithsej 191 kandidatë të pranishëm, kanë kaluar 104 ose 54% e kandidatëve të pranishëm. Në tabelën 7.1 janë dhënë të dhëna të detajuara për kandidatët e pranishëm të cilët e kanë dhënë provimin për agjentë në vitin 2025, sipas shoqërisë pensionale.


Tabela 7.1. Kandidatët e pranishëm të cilët e kanë dhënë provimin për agjentë sipas shoqërisë pensionale në vitin 2025

Shoqëria pensionale	Të pranishëm	Kanë kaluar	Kanë kaluar (në %)
SAVA	53	27	51%
BK e pare	53	27	51%
TRIGLAV	47	25	53%
VFP	38	25	66%
Gjithsej	191	104	54%

Gjatë vitit 2025, u krye regjistrimi i gjithsej 58 agjentëve, nga të cilët 17 agjentë të SAVA-s, 9 agjentë të KB Prvo, 10 të TRIGLAV dhe 22 agjentë të VFP. Regjistrimi i përsëritur u krye për 1 agjent të SAVA-s dhe 1 agjent të TRIGLAV. Gjatë vitit 2025, gjithsej 6 agjentëve u ka pushuar statusi i agjentit, nga të cilët 4 agjentë të SAVA-s, dhe nga një agjent i BK shoqëria e parë pensionaledhe TRIGLAV. Nga dhjetori i vitit 2023, është hequr obligimi i shoqërisë pensionale për të kryer rinovim vjetor të regjistrimit të agjentëve. Pasqyra e numrit dhe vlerave mesatare të statuseve të regjistruara, të rinovuara dhe të pushuara të agjentëve nga viti 2020 deri në vitin 2025 sipas shoqërisë pensionale, është dhënë në grafikun 7.1. Mund të vërehet se numri i agjentëve të regjistruar (numri i agjentëve që janë regjistruar përsëri është përfshirë në numrin e agjentëve të regjistruar) te të gjitha shoqëritë pensionale në vitin 2025 është më i vogël në krahasim me vitet e mëparshme.

[37] *Regjistrimi i përsëritur i një agjenti për një shoqëri pensionale kryhet për një agjent i cili më parë ka qenë agjent aktiv i një shoqërie tjetër pensionale.*

Grafiku 7.1. Numri i statuseve të regjistruara, të rinovuara dhe të pushuara të agjentëve sipas viteve dhe shoqërive pensionale



Për sa i përket numrit të kontratave për anëtarësim në fondet e detyrueshme pensionale, të cilat i lidhin agjentët nga fillimi i punës së sistemit, nga grafiku 7.2 mund të vërehet se më së shumti agjentë, të cilët mesatarisht kanë lidhur edhe më së shumti kontrata për anëtarësim, ka në vitin 2005, duke pasur parasysh se ai ishte fillimi i sistemit, dhe deri më 31.12.2005, ishte afati i fundit që anëtarët vullnetarë të zgjidhnin nëse do t'i bashkoheshin sistemit me dy shtylla dhe të nënshkruanin kontratë. Në vitet në vijim, numri i agjentëve, të cilët lidhin kontrata, vazhdimisht zvogëlohet nga viti në vit, ndërsa njëkohësisht rritet numri mesatar i kontratave të lidhura për agjent, deri në vitin 2011. Më pas, deri në vitin 2014, numri mesatar i kontratave të lidhura për agjent bie ndjeshëm. Në vitet në vijim, numri i agjentëve që kanë lidhur kontrata dhe numri mesatar i kontratave të lidhura për agjent mbeten në një nivel përafërsisht të ngjashëm. Në vitin 2019, kur filloi të punojë shoqëria e tretë pensionale, sërish vërehet rritje e numrit të agjentëve që kanë lidhur kontrata, si dhe rritje minimale e numrit mesatar të kontratave të lidhura për agjent në krahasim me vitin 2018. Rritja e numrit mesatar të kontratave të lidhura për agjent vazhdon edhe në katër vitet e ardhshme, më së shumti për shkak të rritjes së numrit mesatar të kontratave të lidhura për agjent te TRIGLAV. Në vitin 2024, numri mesatar i kontratave të lidhura për agjent mbetet pothuajse në të njëjtin nivel si në vitin 2023. Ndërsa, numri i agjentëve që kanë lidhur kontrata në vitin 2024 mbetet në të njëjtin nivel si vitin e kaluar te SAVA, ndërsa te BK shoqëria e parë pensionaledhe te TRIGLAV ka zvogëlim. Në vitin 2025, numri mesatar i kontratave të lidhura për agjent zvogëlohet në krahasim me vitin 2024. Numri i agjentëve që kanë lidhur kontrata në vitin 2025 pak rritet te KB Prvo, ndërsa pak zvogëlohet te SAVA dhe te TRIGLAV.

Grafiku 7.2. Numri i agjentëve që kanë lidhur kontrata për anëtarësim në fdp dhe numri mesatar i kontratave për agjent

